

Nr. Pr. 28/2

Dt. 16.02.18

**RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM
PËR PROGRAMIN E STUDIMIT JOUNIVERSITAR, PROFESIONAL
PAS ARSIMIT TË MESËM, ME KOHË TË PLOTË
NË “GJEODEZI”
OFRUAR NGA “KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS”**

Ekspertë të vlerësimit të jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Gafur MUKA

Dr. ing. Thomaq KOBLARA



Shkurt /2018

**RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM
PËR PROGRAMIN E STUDIMIT JOUNIVERSITAR, PROFESIONAL
PAS ARSIMIT TË MESËM, ME KOHË TË PLOTË
NË "GJEODEZI"
OFRUAR NGA "KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS"**

Ekspertë të vlerësimit të jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Gafur MUKA
Dr. ing. Thomaq KOBLARA



Shkurt /2018

TKB

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e Studimit profesional dy vjeçar në Gjeodezi

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Profesional i Tiranës
2	Departamenti që e ofron	Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara
3	Urdhëri/VKM i licencimit Leja e fillimit të aktivitetit	Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 699, datë 26.08.2015 Leja e fillimit të aktivitetit: Urdhër Nr. 426, datë 06.11.2015
4	Titulli i programit të studimit:	Program Studimi jouniversitar, profesional, pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë, në Gjeodezi
5	Cikli i studimit:	N/A Program studimi me karakter profesional
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
7	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	Po
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	5
15	Aktivizimi i programit të studimit	2016-2017
16	Numri total i studentëve për program studimi	25

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e ASCAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u kontraktua nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për të bërë vlerësimin e jashtëm të programit të studimit jouniversitar, profesional, pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë në “Gjeodezi”, ofruar nga Kolegji Profesional i Tiranës. Procesi i vlerësimit të jashtëm ka si qëllim të japë një mendim të pavarur për shkallën në të cilën institucioni në fjalë është i përgatitur dhe i angazhuar të përmbushë me efektivitet dhe përgjegjshmëri kërkesat dhe standardet e diplomave që do të lëshojë. Për të arritur në këtë gjykim, GVJ u mbështet në shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), në dokumentacionin bazë mbi të cilin ngrihet veprimtaria e Institucionit (statuti, rregullorja, etj), dosjen e programit të studimit, regjistrat bazë të përcaktuar nga udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), dokumentacionin e zyrës së burimeve njerëzore, takimet e vizitat e organizuara në institucion etj. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve, vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë plotësuese, mënyrat e vlerësimit të njohurive, përcaktimin e krediteve, kompetencën e stafit pedagogjik, etj. Kolegji Profesional i Tiranës, si pronë e shoqërisë tregtare “KPT Sh.p.k”, themeluar sipas së drejtës shqiptare më 18 shkurt 2015 me numër NIPT L51420003Q, e ushtron aktivitetin e tij bazuar në Licensën e dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave numër 699, datë 26.08.2015 “Për Licensimin e Institucionit të Arsimit të Lartë, privat me statusin e Kolegjit Profesional, Kolegji Profesional i Tiranës (KPT), botuar në Fletoren Zyrtare numër 154, datë 02.09.2015, për të ofruar programe të studimeve jouniversitare, profesionale pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë në drejtimet: Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Elektronikë, Data Base dhe Web Design, Teknologji e Instalimeve Elektrike, Elektromekanikë, Teknologji Automjetesh, Mekatronikë, Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi, Gjeodezi, Teknologji Ndërtimi.

Mbi këtë bazë, Institucioni ka nxjerrë dhe akte të tjera si Statutin e Universitetit, Rregulloren bazë të tij, Rregulloret e Programeve të Studimeve etj. KPT është paisur me Lejen e Fillimit të Aktivitetit me Urdhër nr. 426, datë 06.11.2015, “Për lejimin dhe ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me licensën e dhënë institucionit të arsimit të lartë privat, Kolegji Profesional i Tiranës (KPT).

KPT është akredituar edhe institucionalisht me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 66, datë 21.09.2017. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i gjeti këto dokumente si anekse të DVV dhe i konsultoi ato edhe gjatë vizitës në institucion. Programi i Studimit Profesional Jouniversitar 2 vjeçar “Gjeodezi” ka për qëllim të përgatisë studentët me njohuri të thella tekniko-praktike të nivelit profesional, të cilat kërkohen në kushtet e realizimit të aktivitetit praktik të gjeodetëve, si dhe t’i aftësojë ato për të qenë në gjendje të kuptojnë, përvetësojnë e zbatojnë teknologjitë e reja në fushën e gjeodezisë. Ky program studimi, ashtu si edhe programet e tjera të KPT, inkuadrohet në Nivelin e 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, duke synuar përgaditjen dhe diplomimin e specialistëve me diplomën “Teknik i Lartë”

Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm është dërguar në KPT nëpërmjet sistemit më datë 16.01.2018 dhe me shkresë zyrtare me Nr 28 prot, datë 17.01.2018 “Dërgohen Draft raportet e vlerësimit të jashtëm”. KPT me shkresë Nr.199/4 prot, datë 12.02.2018 përcjell në ASCAL “Përgjigje Tuajës nr.28 prot, datë 17.01.2018 mbi Draft Raportet e Vlerësimit të Jashtëm”, duke u shprehur që nuk ka asnjë vërejtje mbi këtë Draft Raport. Për këtë arsye Raporti merr formën e tij përfundimtare.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof. Asoc. Dr Gafur MUKA

2. Dr. Thomaq KOBLARA

Menaxhere teknike e ndjekjes së vlerësimit të kësaj procedure është, Znj. Majlinda Demirneli.

Parimet e Punës së GVJ

Pas marrjes së njoftimit dhe trajnimit nga specialistët e ASCAL, Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), nëpërmjet aksesit në portalin e agjensisë, i'u vu në dispozicion gjithë dokumentacioni i dosjes së vetëvlerësimit (DVV). Po ashtu i'u ofrua dhe DVV në hard copy. Në këto kushte GVJ filloi shqyrtimin e dokumentacionit dhe vendosi të përdorë si burim kryesor informacioni, **Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB)**, dërguar nga Kolegji Profesional i Tiranës (KPT) në ASCAL më 20.11.2017. RVB ekspozon një modulim të qartë të misionit dhe objektivave të programit, të strukturës akademike të njësisë bazë, personelit akademik dhe mbështetës të programit të studimit, infrastrukturës në funksion të programit të studimit, logjistikës dhe shërbimeve të tjera ndaj komunitetit, financimit dhe menaxhimit të burimeve financiare, sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, organizimit të programit të studimit, mësimdhënies, studentëve, aktiviteteve profesionale në funksion të PS si dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. RVB mbyllet me konsiderimin e analizës SWOT, ku evidentohen pikat e forta, pikat e dobta, oportunitetet dhe pengesat nga këndvështrimi i vetë institucionit. Grupi i RVJ pasi e studioi me vëmendje këtë material si dhe gjithë dokumentacionin mbështetës të tij, evidentoi problemet ku duhej të përqëndrohej gjatë vizitës në institucion dhe, në bashkëpunim me specialistët e ASCAL, hartoi axhendën e kësaj vizite. Kjo vizitë, në mënyrë të organizuar, u krye në datat 14 dhe 15.dhjetor. Në këtë vizitë GVJ u shoqërua nga specialistet e ASCAL-it Suela Linza, Renata Qatipi dhe Majlinda Demirneli. Gjatë kësaj vizite, pasi mori kontaktin e parë me koordinatoren e institucionit (KI), GVJ zhvilloi takime me Rektorin, Përgjegjësat e Departamenteve, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, Përgjegjësen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrës së zhvillimit të kurrikulave, stafin akademik efektiv të Departamentit dhe me pedagogë të ftuar të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, sekretarinë mësimore, stafin e Zyrës së Informimit e Mbështetjes së Studentëve dhe stafin e Zyrës së Burimeve Njerëzore. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat e mësimdhënies, laboratorët, ambientët e praktikave, bibliotekën, etj. Gjithashtu u zhvillua një bashkëbisedim me një grup studentësh të këtij programi studimi. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që i'u vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura.

1. Misioni dhe Objektivat e programit të studimit

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e programit të studimit, mësimdhënia, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për programin e studimit (historiku, numri i punonjësve në vite, numri i studentëve në vite, vendi i Programit të studimit në kuadrin e kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Misioni dhe objektivat e programit të studimit jouniversitar, profesional, pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë (dy vjeçar) “Gjeodezi” janë të përfshira në misionin dhe objektivat e KPT, me synimet:

- Të ofrojë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme, që të ndihmojnë studentët të kenë sukses në gjetjen e mundësisve të punësimit me një nivel të kënaqshëm të ardhurash duke hartuar një kurrikul të orientuar drejt praktikave, për t'iu përgjigjur kërkesave të punëdhënësve por, edhe me synimin e përgaditjes së studentëve për studime universitare.
- Të jetë një ndër ofruesit më të rëndësishëm të arsimit profesional në vend, një urë lidhëse midis edukimit akademik dhe trajnimit profesional, duke i ndihmuar studentët në integrimin sa më të lehtë në tregun e punës.
- T'u sigurojë profesionistëve të rinj një qendër ku të njihen me inovacionet që janë pjesë e studimeve të ofruara.
- Të sigurojë një bazë të mjaftueshme njohurish për të mundësuar transferimin e studimeve në nivele më të larta universitare.

Qëllimet dhe objektivat e programit të studimit jouniversitar profesional me kohë të plotë "Gjeodezi"

Ky program studimi, referuar rregullores së tij, ka për qëllim ta pajisë studentin me:

- a. Njohuri për shërbimet e kërkuara në fushën e matjeve profesionale inxhinierike e gjeomatike
- b. Aftësi për përdorimin e instrumentave modern të precizionit të lartë për matjen dhe rregjistrimin e distancave, këndeve, lartësive si dhe sistemet e avancuara për përcaktimin e pozicionit si Global Position System (GPS)
- c. Njohuri dhe teknika praktike të matjeve si dhe njohjen e teorisë e praktikës së rilevimeve
- d. Aftësi praktike përmes punës së supervizuar në terren, laboratore, projekte e detyra
- e. Aftësim për të punuar me paisje moderne
- f. Aftësi që mundësojnë futjen në tregun e punës në fushën e zbatimit të projekteve, veprave inxhinierike, ndërtimit të rrugëve, mirëmbajtjes dhe rikonstruksionit të objekteve ndërtimore të tipologjive të ndryshme.

Në përfundim të studimeve, studentëve të këtij programi u krijohen mundësitë të integrohen në tregun e punës por edhe të kenë fituar bazat e nevojshme për të thelluar studimet në arsimin e mëtejshëm universitar. Për të realizuar misionin dhe objektivat, këtij PS i ishin vënë në dispozicion instrumenta dhe pajisje të pothuajse gjithë gjeneratave, duke filluar nga ato të thjeshta e analoge e, duke përfunduar me instrumentat e paisjet dixhitale dhe sistemet GPS. Këto paisje ndodheshin në laboratorin përkatës, por ofroheshin edhe nga firma me profilizim në fushën e matjeve topografike, me të cilat ishin lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Ky program studimi realizohet në kuadrin e departamentit të Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara, i cili ka një staf të përbërë nga: për vitin akademik 2016-2017 11 pedagogë efektivë (PAE), dhe 15 me kontratë (PAK), dhe për vitin akademik 2017-2018, 13 pedagogë efektivë (PAE), dhe 13 me kontratë (PAK) Gjatë takimit me këtë staf GVJ u njoh më nga afër me angazhimin e tyre si në hartimin e syllabuseve ashtu edhe në zhvillimin e procesit mësimor- leksioneve, seminareve, laboratorëve dhe praktikave.

Në tërësi, GVJ konstatoi se egzistojnë kushtet për realizimin e misionit dhe objektivave të këtij program studimi. Edhe pse në dy vitet e para të hapjes numri i studentëve të rregjistruar ka qenë relativisht i vogël (15 për vitin 2016-2017 dhe 11 për vitin 2017-2018) vlerësojmë që:

1. Punësimi i studentëve të parë do inkurajojë më shumë rregjistrime
2. Vetë firmat e specializuara në këtë fushë do rekomandojnë kontaktet e tyre për të studiuar në këtë PS.

Këtë prirje e dëshmonte edhe prania e së paku 1 studenti, që krahas studimit ishte i punësuar në një firmë, e cila e kishte rekomanduar të ndiqte këtë Program Studimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi 1: Aftësitë specifike të lidhura me sektorin e punësimit janë zhvilluar, monitoruar dhe vlerësuar gjatë gjithë zhvillimit të programit të studimit

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Punësimi është trajtuar në hartimin e kurrikulave, në karrierën arsimimin, informimin dhe udhëzimet.

Kriteri 2 Punësimi është një çështje kyçe për miratimin e programit, monitorimin dhe rishikimin e tij.

Kriteri 3 Studentëve i është dhënë mbështetje për zhvillimin e aftësive në funksion të punësimit.

Kriteri 4 Programi parashikon dhe kredite të përfituara gjatë punës

Kriteri 5 Të përfshijnë inisiativa specifike si psh. mbështetje për sipërmarrjen

Kriteri 6 Krijimi i lidhjeve punëdhënës / IAL.

Vlerësimi sipas standardit 1:

Për vlerësimin e këtij standardi, GVJ shqyrtoi fillimisht RVB duke i kushtuar vëmendje të posaçme përmbajtjes së kurrikulave, kompozimit të syllabuseve, bazës laboratorike dhe bashkëpunimit me sektorët potencialë të punësimit. Në të gjitha takimet me faktorët e lidhur me mësimdhënjen, GVJ u interesua të mësonte gjendjen konkrete lidhur me mënyrën se si transmetoheshin njohuritë tek studentët dhe shkallën e përvetësimit të këtyre njohurive në nivelin e aftësisë praktik.

Në analizë të kurrikulës së këtij programi studimi konstatohet që disiplinat e formimit karakterizues të programit (B) si dhe ato të ngjashme apo integruese me to (C), zënë një peshë prej 66 kreditesh ECTS, të cilave po t'u shtohen edhe 13 kredite të disiplinave me zgjedhje (D) dhe diplomës, përkatësisht provimit të formimit, bëhen 79 kredite që në % përkundrejt totalit prej 120 kreditesh janë afërsisht 66%. Ky rezultat tregon që në aspektin e formimit profesional, kurrikula i aftëson studentët që, në përfundim të studimeve, të jenë në gjendje të demonstrojnë aftësi e shprehin konkrete të lidhura me sektorin e punësimit. Nga kurrikula konstatohet gjithashtu që raporti i leksioneve dhe ushtrimeve për lëndët e përmendura është në favor të ushtrimeve (53% kundrejt 47%), ndërkohë që për praktikën në terren ky raport vete deri në 70%. Për shkak se kontigjenti i parë i studentëve nuk është futur akoma në tregun e punës, GVJ e ka të pamundur për të vlerësuar me tregues të matshëm nivelin e punësimit dhe për të gjykuar ecurinë në karrierë të të diplomuarve të këtij PS. Gjatë takimit me studentët konstatohet që ata ishin mjaft të informuar për tregun e punës edhe nga fakti se ishin në kontakte të vazhdueshme me firma, të cilat kishin aktivitet në fushën e matjeve gjeodezike.

Rritjes së aftësive praktike, që lidhen direkt me punësimin i shërben edhe forcimi i bazës laboratorike. GVJ konstatoi që po punohej për pasurimin e saj. Laboratorit i viheshin në dispozicion instrumenta e pajisje të firmave bashkëpunuese si Gjeo-Vjosa etj. Këto instrumenta si Total Station, Nivelat dixhitale dhe sisteme GPS, u shërbejnë studentëve për të operuar me teknologjinë moderne dhe për të hyrë me siguri profesionale në tregun e punës. Në zhvillimin e punëve të laboratorit, për lëndë të veçanta, ishin hartuar udhëzues për punët laboratorike nëpërmjet të cilëve studentët mësonin të realizonin matjet konkrete, përpunimin e tyre dhe vizualizimin grafik.

Lidhur me vlerësimin e shprehive të fituara gjatë praktikës profesionale konstatuam që studentët merrnin 10 kredite në kushtet e ndjekjes së rregullt të saj, paraqitjen e proceseve të kryera si dhe aftësisë për ta mbrojtur para një komisioni të ngritur me miratimin e departamentit. Gjatë bisedës me studentët e vitit të dytë, GVJ mësoi që ata ishin të interesuar për frekuentimin e saj, pasi merrnin përsipër kryerje matjesh konkrete dhe kështu realizonin një produkt përfundimtar të matshëm. Sa u përket inisiativave specifike lidhur me punësimin, konstatohet që studentët ishin në kontakt me

punëdhënësit dhe interesoheshin që t'i zgjerohin e forconin këto kontakte. Prania e personelit me kontratë, që vinin nga firma me aktivitet në fushën e matjeve apo ndërtimit, krijonin atmosferën e kontaktit të pandërprerë me sektorin e punësimit. Studentët ishin të informuar edhe për zhvillimet më të fundit lidhur me mundësitë e punësimit dhe bënin përpjekje që ta fitonin sa më shpejt statusin e të punësuarit. Dëshmi për këtë ishte prania e së paku një studenti i cili ishte aktualisht i punësuar. GVJ konsultoi dhe kontratat e nënshkruara nga institucioni me shoqëri dhe biznese të ndryshme që operojnë në treg, veprimtaria e të cilave lidhet me punimet topografike në sektorët e ndërtimit, projektimit e konstruktimit të rrugëve të transportit, kadastrës etj. Në këto kontrata dëshmohen, përveç të tjerash edhe lidhjet e mira dhe të qëndrueshme të institucionit me tregun e punës.

Konkluzionet e GVJ:

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, të takimeve të zhvilluara në institucion si me drejtuesit e tij ashtu edhe me pedagogët e studentët, gjithashtu edhe nga vizita në ambientet mësimore, laboratorike e ato të zhvillimit të praktikave, GVJ konkludon:

1. Kurrikula e programit të studimit "Gjeodezi" është kompozuar në mënyrë të tillë që studentët të fitojnë njohuri që lidhen drejtpërsëdrejti me tregun e punës. Ata aftësohen për të matur dhe përpunuar të dhënat pozicionale si dhe ndërtimin e produktit të tyre, që janë kryesisht hartat e shkallëve të mëdha.
2. Baza laboratorike e PS është e plotë duke marrë në konsideratë numrin e pakët të studentëve që aktualisht ndjekin këtë program studimi. Bashkëpunimi i tanishëm, sidomos me firmën Gjeo-Vjosa mundëson një shfrytëzim eficient të bazës instrumentale bashkëkohore. Sidoqoftë shtimi i numrit të studentëve, krahas avantazhit që sjell për rritjen e dobisë së këtij programi studimi kërkon edhe rritjen e investimeve për të shtuar si numerikisht ashtu edhe cilësisht bazën laboratorike.
3. Kryerja e praktikave mësimore në mjedise ku aktiviteti kërkon realizimin e një produkti konkret, e rrit përgjegjësinë e studentëve edhe për të punuar saktë por edhe për të frekuentuar rregullisht zhvillimin e praktikës. Detyrimi për ta mbrojtur relacionin e praktikës para një komisioni të ngritur nga departamenti, në mënyrë që të fitohen kreditet maksimale të vënë në dispozicion të saj, i inkurajon studentët për një përgaditje sa më cilësore.

Në përfundim GVJ konkludon që institucioni e **përbush këtë standard.**

2. Struktura akademike e Njësisë Bazë - Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara (EMSA)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për personelin akademik në njësinë bazë, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ, koordinimi i mësimdhënies me njësi të tjera të institucionit.

Në RVB, në kapitullin përkatës "Struktura Akademike e Njësisë Bazë", paraqitet situata e organizimit të Njësisë Bazë, elementët përbërës të saj, funksionimi i tyre, niveli i plotësimit të kësaj strukture si me personel ashtu edhe me ambiente e mjete mësimore të cilat, në bashkëveprimin e tyre, përcaktojnë ecurinë e realizimit të programit. Bazuar në të dhënat e këtij raporti si dhe në njohjen konkrete me të gjithë elementët përbërës të saj gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi:

Kolegji Profesional i Tiranës fillimisht, në vitin 2015-2016, ka qenë i organizuar në tre departamente:

- Departamenti i Teknologjisë së Informacionit
- Departamenti i Elektro Mekanikës
- Departamenti i Ndërtimit dhe Sistemeve të Aplikuara.

Pas përvojës së parë, në dhjetor 2016, Departamenti i Elektro Mekanikës dhe ai i Ndërtimit dhe Sistemeve të Aplikuara dolën me propozimin për t'u organizuar në një departament të vetëm. Në përgjigje të pyetjes përse u propozua ky ndryshim, GVJ mësoi se këtë e diktoi mosrealizimi i pritshmërisë në rregjistrime, vështirësitë në angazhimin me efikasitet të personelit si dhe nevoja për kompaktësimin e strukturës. Për të jetësuar këtë propozim është marrë vendimi Nr. 22 prot. datë 05.12. 2016 i Senatit Akademik të Kolegjit Profesional. Departamenti i ri është quajtur "Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara". Aktualisht në këtë institucion funksionojnë dy departamente:

1. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit
2. Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara (EMSA)

Programi i studimeve "Gjeodezi" përfshihet në departamentin e Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara, i cili është dhe departamenti përgjegjës për këtë PS, ndërkohë që Departamenti i Teknologjisë së Informacionit është mbështetës. Funksionimi i departamentit ishte i përcaktuar në statutin e KPT-së si më poshtë:

Departamenti është njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplina mësimore respektive. Në këtë kuadër ai:

- a. Nxiti, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënjes, veprimtaritë kërkimore ose praktike, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik.
- b. Mund të organizohet në grupe mësimore kërkimore.

Nga biseda me përgjegjës të departamentit, GVJ konstatoi që departamenti EMSA ishte i angazhuar në zbatimin e detyrave sipas statutit. Si specifikë e institucionit, këtu nuk kishte grupe mësimore-lërkimore. Për realizimin e kurrikulës mësimore departamenti kishte në përbërje shtatë laboratore dhe 3 ofiçina, nga këto 2 laboratore: ai i fizikës dhe ai i Gjeodezisë ishin në shërbim të këtij programi. Struktura të tjera mbështetëse për PS në "Gjeodezi" ishin dhe sekretaria mësimore si dhe stafi administrativ i institucionit të cilët, me funksione të përcaktuara po sipas statutit të KPT dhe rregullores së Programit të Studimit, kryenin të gjitha aktivitetet në mbarëvajtje të procesit mësimor. Stafi akademik i Departamentit për vitin 2017-2018 përbëhej nga 26 persona. Nga këta personel efektiv ishin 13 vetë (3 me grada dhe tituj) ndërsa personel me kontratë 13 vetë (3 me grada dhe tituj). Sipas RVB personeli me kontratë ishte i kontraktuar deri në fund të semestrit të parë të vitit 2017-2018. Stafi administrativ, në mbështetje të aktiviteteve të këtij departamenti, për vitin 2017-2018 përbëhet nga 14 antarë. GVJ mësoi se kishte një rritje prej 10 vetësh në krahasim me vitin 2015-2016, e cila ndikonte në rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve.

Tregues të matshëm:

- Struktura didaktike e Departamentit për programin e studimit

Pjesë e strukturës së departamentit janë 7 laboratorë dhe tre ofiçina si vijon:

1. Laboratori i Fizikës
2. Laboratori i Mekanikës dhe shkencave materiale
3. Laboratori i Pneumatikës dhe Elektropneumatikës dhe PCL (Programmable Logic Controller)
4. Laboratori i Autotronikës
5. Laboratori i Makinave elektrike
6. Ofiçina e automjeteve dhe Mekanikës
7. Ofiçina e Makinave elektrike
8. Laboratori i Gjeodezisë
9. Laboratori i HVAC (Heating Ventilation Air Condition) dhe Termoteknikës

10. Oficina e HVAC

Nga këto laboratore 2 prej tyre konkretisht, laboratorit i fizikës dhe laboratorit i gjeodezisë janë në funksion të këtij programi.

- Numri i personelit akademik në Departament: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personeli Administrativ (PA), titujt/gradat, (Tabela 1, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 1

Viti akademik	Stafi akademik i Departamentit të Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara							
	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i Stafit Administrativ		Total	
	GJ	Tituj/Grada	GJ	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	GJ	Tituj/Grada
2015 - 2016	16	2	3	1	*	N/A	19	3
2016 - 2017	11	3	15	5	*	N/A	26	8
2017-2018	13	3	13	3	*	N/A	26	6

Në Tabelën 2 jepet stafi akademik PAE dhe PAK në departamentin e Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara

Tabela 2

Stafi akademik Departamenti i Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara (2017-2018)							
PAE (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	PAK (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Marenglen Gjonaj	Përgj. Departamenti	Prof. Dr	1	Miranda Kullolli	Prof. Asoc.	UPT
2	Antoneta Deda	Pedagog	Prof. Dr	2	Elfrida Topçiu	Dr.	Pension
3	Arben Dushi	Pedagog	Prof.As.	3	Idajet Selmani	Msc.	Shkolla e mesme Zall Bastar
4	Piro Dhimitri	Pedagog	Msc.	4	Luisa Dhimitri	Msc.	-
5	Konti Tafa	Pedagog	Msc.	5	Migena Zeqo	Msc.	UPT
6	Ilir Palushaj	Pedagog	Msc.	6	Preni Muça	Msc.	Pension
7	Teuta Halilaj	Pedagoge	Msc.	7	Marsida Ibro	Msc.	AMD(Durres)
8	Marjeta Dhima	Pedagoge	Msc.	8	Zamir Rira	Ba	-
9	Artur Ruzi	Pedagog	Msc.	9	Memush Habilaj	Msc.	Pension
10	Vladimir Sinani	Pedagog	Msc.	10	Malvina Marku	Msc.	UT. Fak. Shkencave Natyrës
11	Leon Merja	Pedagog	Msc.	11	Emiljano Qose	Msc.	-
12	Sashenka Avrami	Pedagoge	Msc.	12	Genc Salja	Msc.	-
13	Gerald Shkreta	Pedagog	Msc.	13	Përparim Lika	Dr.	-

Departamenti plotëson kërkesat për numrin e përgjithshëm të stafit dhe numrin e stafit me tituj /grada.

3. Personeli akademik dhe ai mbështetës për Programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik i angazhuar për zhvillimin e procesit mësimor në programin e studimit “Gjeodezi” është trajtuar në kapitullin 3 të RVB. Mbështetur në të dhënat e këtij raporti si dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që në departament janë gjithsej 26 vetë, të klasifikuar si Personel Akademik Efektiv (PAE), Personel Akademik me Kontratë (PAK) si dhe Personel Administrativ. Vetëm personeli akademik (PAE+PAK), i anagazhuar për PS “Gjeodezi”, kuotohet në **16 persona**. Kualifikimi i personelit PAE përfshin të diplomuarit në Msc, me titullin Prof. Asoc. Dr. dhe me titullin Prof. Dr ndërsa ai PAK përfshin të diplomuar në Ba, Msc, me gradën shkencore Dr. dhe me titullin Prof. Asoc. Dr. Sa i përket personelit administrativ ai është i përgjithshëm (jo vetëm për PS Gjeodezi) për shkak të numrit të vogël të studentëve (gjithsej 26) në të 2 vitet e studimeve. Personeli Akademik duhet të përballojë ngarkesën mësimore prej 120 kreditesh ECTS të shpërndarë në të dy vitet e studimeve, përkatësisht në 4 semestra si vijon:

31 kredite përkatësisht 775 orë mësimore semestri I
30 kredite përkatësisht 750 orë mësimore semestri II
30 kredite përkatësisht 900 orë mësimore semestri III
29 kredite përkatësisht 725 orë mësimore semestri IV

Sipas RVB kjo ngarkesë është shpërndarë mbështetur në nivelin e kualifikimit dhe arrin nga 120-150 orë për Prof. Dr., 260 orë për Prof. As, Dr, dhe 360 orë për Msc. Në përcaktimin e këtyre normave janë marrë në konsideratë: ligji për Arsimin e Lartë dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Sasia vendoset nga administratori në marrveshje me senatin dhe shënohet në kontratën e punës. GVJ u interesua edhe për mënyrën e rekrutimit të personelit akademik dhe mësoi se ai rekrutohet me konkurs pas shqyrtimit të dokumentacionit nga një komision i posaçëm që përbëhet nga Rektori, Administratori, Përgjegjësi i Departamentit, Përgjegjësi i Zyrës së Burimeve njerzore dhe, sipas rastit edhe një person nga stafi akademik (që ka kopetencë profesionale). Pas përzgjedhjes së kandidatave, vendimin për punësim e merr Rektori. Në kriteret e shpallura me rëndësi janë shkalla e kualifikimit (duhet të jetë së paku zotërues i diplomës Master Profesional), përvoja në mësimdhënie si dhe eksperiencia e punës. Si rektori ashtu edhe shefat e departamenteve shprehën synimin e tyre për të punësuar personel me cilësi të spikatura profesionale duke i kushtuar vëmendje institucionit ku ishin diplomuar si dhe atij ku kishin zhvilluar aktivitet. Për verifikimin e përmbushjes së kriterëve, sidomos atyre që lidhen me mësimdhënjen dhe komunikimin, kandidatët i nënshtroheshin edhe intervistimit nga komisioni dhe zhvillimit të një leksioni të hapur.

Thuajse e njejta procedurë ndiqej edhe për stafin joakademik, veçse për këtë shpallehin kriteret që nuk lidhen me mësimdhënien. Punësimi i PAK bëhej mbi bazën e marrëveshjes institucionale midis IAL ku ushtrote aktivitetin personi dhe KPT, duke depozituar pranë Zyrës së Burimeve Njerzore gjithë dokumentacionin e kërkuar. Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerzore, për të verifikuar dosjet e personelit, zgjodhëm dy dosje rastësore të cilat rezultuan të plota sa i përket dokumentacionit.

Interesimi i GVJ lidhur me mbështetjen e personelit për kualifikim mori përgjigjen që për kohën e shkurtër të aktivitetit akoma nuk janë realizuar programe të posaçme por, me mbështetjen e shoqërisë Polytech S.A, nga e cila marrim paisje laboratorike, kemi realizuar kualifikime për drejtuesit e punëve laboratorike.

Tregues të matshëm:

- Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për programin e studimit (Tabelat 3, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Në Tabelën 3 janë dhënë të ndarë stafi akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në programin e studimit.



Tabela 3

Stafi akademik i programit të studimit Gjeodezi për vitin akademik 2017 - 2018 (***)						
PAE (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	PAK (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Shpëtim Bozo	Prof .Dr	1	Idajet Selmani	Msc	Pension
2	Antoneta Deda	Prof. Dr	2	Luisa Dhimitri	Msc	Shkolla e mesme” Zall Bastar”
3	Teuta Halilaj	Msc	3	Illir Shinko	Dr	UPT
4	Ervin Suli	Msc	4	Esmeralda Berdufi	Msc	MPB
5	Sashenka Avrami	Msc	5	Perparim Lika	Msc	UPT
6	Erion Curraj	Msc	6	Preni Muca	Msc	Pension
7	Petro Plasa	MND	7	Emiliano Qose	Msc	Nuk ka
			8	Genc Salja	Msc	Nuk ka
			9	Anisa Curraj	Msc	Nuk ka

***) të dhënat janë nxjerrë nga Tabela 10 e RVB

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre** (Tabela 3.2, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 3.2

Titulli	Programi i studimit Gjeodezi		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	2	0	2/0
Profesorë të As.	0	0	0/0
Doktorë	0	1	0/1
MND	1	0	1/0
Msc	4	8	4/8
	7	9	7/9

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat.**

Në dosjet e personelit tek Zyra e Burimeve Njerzore, GVJ gjeti kontratat e punës të lidhura midis KPT dhe stafit akademik, në plotësim të kërkesave të ligjit 80/2015, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në Kodin e Punës. Në këto kontrata evidentoheshin qartë detyrimet dhe të drejtat e punëdhënësit dhe punëmarrësit. Për PAE kontratat e punës ishin pa afat ndërsa për PAK ato nënshkruheshin për çdo semestër. Në zyrën e burimeve njerzore, GVJ u njoh me dy Dosje të zgjedhura në mënyrë rastësore (të dy pedagogëve). Në këto dosje u gjetën të gjitha dokumentat që kërkon rregullorja konkretisht:

- Kontrata e nënshkruar nga punëdhënësi dhe pedagogu
- Diplomë e arsimit të lartë, lista e notave

- CV e pedagogut, (Format i BE)
- Vërtetim page dhe Leja e drejtuesit , kur pedagogu është part time
- Libreza e punës dhe librezë kontributesh (Sig shoqëror dhe Sig. Shëndetësor)
- Raport i aftësisë për punë/librezë shëndetësore
- Etj

☑ Ngarkesa semestrale, vjetore etj

Në RVB thuhet se ngarkesa mësimore e personelit në të gjitha format e saj, fiksohet në kontratën e punës, bazuar në Kodin e Punës, Statutin e KPT, në rregulloret e institucionit si dhe dokumenta të tjera të miratuara nga organet drejtuese të KPT-së. Gjatë shqyrtimit të kontratave të punës, GVJ konstatoi praninë e ngarkesës mësimore si detyrim i punëmarrësit. Përgaditja dhe shpërndarja e ngarkesës është detyrë e Shefit të Departamentit, i cili e realizon atë për gjithë stafin akademik: si atë efektiv ashtu edhe atë me kontratë. Shpërndarja merr në konsideratë funksionet dhe nivelin e kualifikimit të personelit.

Për PS “Gjeodezi” ngarkesa përballohet nga 16 pedagogë nga të cilët **7 PAE** dhe **9 PAK**.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi 2 Aftësi të transferueshme janë zhvilluar, monitoruar dhe vlerësuar gjatë gjithë programit
<p>Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:</p> <p>Kriteri 1 Punëdhënësit ndihmojnë në përcaktimin e përvojave thelbësore (p.sh. përvoja e punës) dhe aftësitë ndër-kurrikulare, qëndrimet dhe njohuritë (p.sh. të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve, komunikimi, TIK, marrëdhëniet me klientët)</p> <p>Kriteri 2 Çdo aftësi është ndjekur përmes moduleve (Përmbajtja e kursit, metodat e mësimdhënies, vlerësimit) në fazat e zhvillimit të kurrikulës dhe nëpërmjet rishikimit të programit.</p> <p>Kriteri 3 Rezultatet janë të monitoruara (p.sh. punësimi i të diplomuarve).</p>
<p><u>Vlerësimi sipas standardit 2:</u></p> <p>Programi i Studimit “Gjeodezi” është i lidhur ngushtësisht me krijimin e bazës së të dhënave nëpërmjet matjeve. Për realizimin e matjeve duhet, më së pari, të fitohen njohuritë mbi mënyrat e krijimit, përpunimit, analizës, vlerësimit e vizualizimit të të dhënave, të disponohen instrumentat dhe paisjet matëse dhe të realizohet puna në terren e cila, në kuadrin e këtij programi, konkretizohet nëpërmjet punëve laboratorike dhe praktikave mësimore. Pra, nëpërmjet këtij aktiviteti praktik realizohet formimi thelbësor i studentëve si dhe aftësimi i tyre për të qenë jo vetëm të kërkuar por edhe të dobishëm për tregun e punës. GVJ pas konsultimit me RVB, gjatë vizitave në Institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion vlerëson se realizimi i këtij PS bazohet në këtë ecuri. Gjatë takimit me studentët, ata konfirmuan vlerën e njohurive që kishin fituar gjatë zhvillimit të laboratorëve e kryerjes së praktikave. Ata gjykonin që formati i kurrikulës dhe struktura e Syllabuseve ishin në masën e duhur formuese sa i përket transmetimit të njohurive teorike dhe, po ashtu, aftësuese sa i përket operimit me teknologjinë matëse. Gjithashtu studentët vlerësonin punën në grup, nëpërmjet së cilës ata ushtronin të mësuarit nga gabimet jo vetëm vetiake por edhe ato të pjesëtarve të tjerë. Kjo mënyrë e realizimit të PS ndikon dukshëm pozitivisht në integrimin pa shumë vështirësi të studentëve në tregun e</p>

punës. Për ta forcuar më tej këtë prioritet, nga institucioni ishin nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi si me aktorë të brendshëm të tregut të punës ashtu edhe me aktorë të jashtëm, kryesisht për trajnim të stafit.

Aftësimi i studentëve realizohet, natyrisht, duke marrë njohuritë teorike nëpërmjet leksioneve, duke i konkretizuar këto njohuri nëpërmjet seminareve e ushtrimeve si dhe duke krijuar produkte vetiake nëpërmjet laboratorëve, praktikave mësimore apo punimeve të diplomimit. Të gjitha këto nivele aktiviteti parashikohen në kurrikulën mësimore dhe detajohen në Syllabuset e lëndëve, të cilat formulohen si module që lidhen e ndërveprojnë ngushtësisht. Në analizë të kurrikulës së programit “Gjeodezi” konstatohet që numri i lëndëve të formimit të përgjithshëm (grupi A) është 3, i disiplinave të formimit karakterizues (grupi B) është 8, i disiplinave formuese të ngjashme/integruese me PS (grupi C) është 3 ndërsa i disiplinave formuese me zgjedhje (grupi D) është 2. GVJ vlerëson që këto module janë të mjaftueshëm për të transmetuar njohuritë në realizim të objektivave të programit të studimit. Sidoqoftë, nga RVB dhe nga vizita në institucion u konstatuan ndryshime të kurrikulës që lidhen me zëvendësim lëndësh, rigrupime e riemërtime apo ndryshim kreditesh. GVJ, në përgjithësi, i gjen me vend këto ndryshime pasi janë bërë me propozim të stafit që realizon programin ndërkohë që hartimi i tyre ishte bërë para se të hapej programi. Kjo na u konfirmua dhe nga biseda me rektorin dhe përgjegjësin e departamentit. Me siguri përvoja në zbatimin e plotë të tyre, zhvillimi i teknologjisë por edhe reagimi i tregut të punës do të çojnë në ndryshime të tjera që do synojnë përmirësimin e tij. Duhet patur kujdes që këto ndryshime të mos e kalojnë masën e përcaktuar në standartet përkatëse.

GVJ konsultoi edhe syllabuset e lëndëve dhe gjeti që strukturimi i tyre është bërë sipas kërkesave të standardeve. Në to jepen shkurt përshkrimi i lëndës, objektivat e saj, mënyra e vlerësimit, masa e frekuentimit të detyrueshëm, rezultatet e pritshme, temat e leksioneve, ushtrimeve dhe punëve laboratorike si dhe literatura. Syllabuset ishin hartuar për të gjitha lëndët dhe ishin nënshkruar nga pedagogu përkatës dhe miratuar nga shefi i departamentit. Nga përmbajtja e tyre konstatohet puna me përgjegjësi e pedagogëve, koordinimi i tyre për të shmangur sidomos përsëritjet dhe përpjekja që dijet të jepeshin sa më thjeshtë dhe kuptueshëm për studentët. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet që studenti lejohet të hyjë në provimin kualifikues nëqë ai ka frekuentuar 60% të leksioneve, 60% të seminareve e ushtrimeve dhe 80% të laboratorëve, ndërkohë që pesha e vlerësimit në rezultat, me pak përjashtime ishte: 10 pikë për pjesëmarrje dhe aktivizim në ushtrime, 30 pikë laboratorik dhe praktika dhe 60 pikë provimi përfundimtar.

Sa i përket kriterit 3, nga RVB del se është punuar në dy drejtime: drejtimi i parë ka të bëjë me informimin e studentëve për gjithshka që lidhet me vlerësimet e rezultateve të punës së tyre duke i orientuar ata drejt njohjes së rregullores së programit të studimit si dhe duke i ndihmuar me caktimin e pedagogëve tutorë të cilët e organizojnë veprimtarinë informuese e konsultuese jashtë kohës së mësimit. Gjatë bisedës me studentët, GVJ u informua që kjo praktikë është e dobishme për ta, sidomos planifikimi dhe realizimi i javës së 15 të simestrit për të përmbushur boshllëqet të krijuara në realizimin e detyrimeve. Sa i përket feedback-ut nga të punësuarit ai mungonte për shkak se akoma nuk është punësuar, së paku, kontigjenti i parë i studentëve nga ky PS.

Standardi 5: Staf i zotëron aftësi, sjellje dhe përvojë të duhur për rezultatet e pritshme të programit

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Të dhëna nga specialistë të sektorit përkatës të punësimit

Kriteri 2 Staf i mësimdhënës angazhohet në përditësimin e mëtejshëm, specifikisht për anën profesionale, lëndët dhe vendet e punës

Kriteri 3 Janë ngritur sisteme për evidentimin e hershëm dhe ofrimin e mbështetjes, për

mbështetjen e të mësuarit tek studentët

Kriteri 4 Stafit ka siguruar mbështetje për studentët me kohë të pjesëshme (part time), p.sh. nëpërmjet email-it, ofrimit të të mësuarit virtual dhe ambienteve përkatëse (e-learning).


Vlerësimi sipas standardit 5:

Të dhënat mbi aftësitë, sjelljen dhe përvojën e stafit u morën nga RVB, dokumentet anekse të tij, biseda me stafin gjatë vizitës në institucion, takimi me studentët si dhe biseda dhe shqyrtimi i dokumentacionit në zyrën e burimeve njerzore. Nga këto procedime rezulton që rekrutimi i personelit bëhet sipas kriterëve të saksionuara në statutin e KPT dhe rregulloren e IAL-së duke i respektuar procedurat lidhur me njoftimin, hartimin e dosjeve, intervistimin e kandidatëve, përzgjedhjen e tyre deri në marrjen dhe shpalljen e vendimit. Në dokumentacionin e shqyrtuar nuk konstatohen parregullsi lidhur me këto procedura. Edhe angazhimi i personelit rezulton konform detyrimeve kontraktuale. Stafit nuk kishte asnjë ankesë lidhur me respektimin e të drejtave të tij. Sa i përket cilësisë së angazhimit, GVJ konstatoi përdorimin me nivel të mirë të përvojës së stafit si në hartimin e kurrikulave ashtu edhe në transmetimin e njohurive në komunikimet me studentët. Në përgjigje të pyetjes lidhur me ndryshimet e bëra në kurrikulën e PS “Gjeodezi” na u tha që ndryshimet janë bërë me kërkesën e stafit akademik të departamentit, çfarë tregon që stafi e ka në vëmendje synimin për të bërë përmirësime lidhur me procesin mësimor të Programeve të Studimeve përfshirë këtu edhe PS “Gjeodezi”. Kjo konstatohet edhe në aktivitetin e stafit lidhur me rifreskimin e Syllabuseve. Shqyrtimi i tyre konfirmonte përpjekjen e çdo pedagogu për të qenë në nivelin e kërkesave të institucionit, për t’u transmetuar studentëve në mënyrë të plotë edhe zhvillimet më të fundit të teknologjisë. Në laboratorin e gjeodezisë ishin paisjet e gjeneratave të fundit si takimetri dixhital, nivela dixhitale, sistemi GPS etj, vënja në përdorim e të cilëve kërkon përfshirjen në syllabuse edhe të metodikave të matjes, përpunimit e vlerësimit të të dhënave. Për mbështetjen e të mësuarit tek studentët, në këtë institucion e, për rrjedhojë edhe në PS “Gjeodezi”, funksionon në rradhë të parë puna konkrete në leksione, seminare, ushtrime, punë laboratorike dhe praktika mësimore duke u ofruar atyre materialet e nevojshme në formën e leksioneve të shkruara, shembujve praktikë, ushtrimeve të zgjidhura, udhëzuesve të punëve të laboratorit etj. GVJ konstatoi që këto materiale ishin të aksesueshme për studentët si në bibliotekën e institucionit ashtu edhe në sistemet online. Po kështu studentët i kishin mundësitë e informimit, konsultimit dhe shlyerjes së detyrimeve të prapambetura nëpërmjet Zyrës së Informimit e Mbështetjes së Studentëve, Sistemit të Tutoriatit, konsultimeve jashtë orarit apo Javës së 15 të semestrit. Informimi realizohej edhe nëpërmjet sistemeve online Classter dhe Intranet, për funksionimin e të cilëve studentët u shprehën pozitivisht

Studimi me kohë të pjesëshme (part time) nuk ofrohet nga ky institucion.

Konkluzionet e GVJ:

Në plotësim të standardeve 2 dhe 5, GVJ konkludon që për programin e studimeve “Gjeodezi” ka arritur në drejtim të kompaktësisë të njohurive të marra me praktikimin e tyre. Ky kompaktësim është realizuar nëpërmjet vendosjes së raportit të drejtë të leksioneve me seminarët, ushtrimet, punët laboratorike dhe praktikën mësimore nga njëra anë (21/45) dhe përfshirjes në proces të bashkëpunimit me firmat që ushtrojnë aktivitet privat në fushën e matjeve gjeodezike/ topografike nga ana tjetër. Praktikimi i njohurive indukon tek studentët sigurinë profesionale, besimin në vetvete, guximin për të hyrë në tregun e punës dhe vetëdijen për t’u kualifikuar më tej. Në realizim të këtij procesi edhe stafi akademik nxjerr konkluzione lidhur me shkallën e përvetësimit të teorisë, nevojën për përditësimin e saj, mjaftueshmërinë e bazës instrumentale laboratorike, cilësinë e produkteve vetiake të studentëve, plotësimet që duhet të bëhen për të rritur cilësinë e tyre, dallimet në aftësinë e studentëve dhe klasifikimin e tyre sipas këtyre aftësive etj. Të gjitha



këto u shërbejnë atyre për të propozuar dhe realizuar ndryshime në kurrikulën mësimore dhe syllabuset e lëndëve të veçanta. Gjithashtu ata janë më të sigurtë në rekomandimet që u lëshojnë studentëve për nivelin e aftësimin të tyre në plotësim të kërkesave që kanë firmat në tregun e punës.

Lidhur me rekrutimin dhe angazhimin e stafit të punësuar, GVJ konstatoi që institucioni i zbaton kriteret e shpallura dhe i respekton detyrimet kontraktuale. Pedagogët nuk kishin ngarkesë më të madhe se sa ajo e dakordësuar në kontratën e punës. Në aspektin e angazhimit të stafit u konstatua që, në realizimin e këtij programi studimi angazhoheshin gjithsej **16 personel akademik** nga ku PAE ishte 7 ndërsa PAK 9, që në përqindje përkthehet **43% me 57%**. Për të shpjeguar këtë raport si Rektori ashtu edhe shefi i departamentit evidentuan numrin e pakët të studentëve që ndjekin këtë PS. GVJ e gjen të arsyeshëm këtë shpjegim *por mendon që ky raport nuk ka ndikim pozitiv në ecurinë e PS*. Edhe pse ai nuk përfshihet në standardet e akreditimit të programit, GVJ rekomandon përmirësimin e tij. Po ashtu angazhimi i një pedagogu në disa lëndë (si psh Sashenka Avrami në 4 lëndë, dhe Pren Muça në 3 lëndë) edhe pse është brenda normës së kontraktuar të ngarkesës, *ka ndikim jo pozitiv në cilësinë e mësimdhënjes dhe shkallën e përvetësimit nga studentët*.

GVJ konstatoi që, edhe për këtë program studimi, informimi dhe mbështetja e studentëve është në plotësim të kriterëve të specifikuar për standardet.

Në përfundim GVJ konkludon që institucioni i **përbush këto standarde**.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Për t'u njohur me infrastrukturën e Programit të Studimit, logjistikën dhe shërbimet e tjera ndaj komunitetit GVJ shqyrtoi RVB, Aneksin Shtesë 25 të DVV, si dhe i vizitoi ambientet, paisjet dhe gjendjen e tyre në adresën: Njësia Bashkiake 4, Rruga "Xhanfise Keko", zona kadastrale 8130 me numër pasurie 5/200. Këtu ndodhet kompleksi "Xhura", tek i cili shoqëria "KPT" shpk, ka marrë me qira një sipërfaqe totale prej 2980 m², të cilën e përdor si ambiente mësimore dhe ndihmëse me synimin që, në kushtet e zgjerimit të aktivitetit deri në 2400 studentë, ta rritë sipërfaqen në dispozicion deri në 12 000 m². Kjo mënyrë e disponimit të ambienteve konfirmohet në Kontratën e Qirasë numër Rep. 3758, No. Kol. 1044, datë 29.09.2015, të ndryshuar. Mësimi zhvillohej në një ndërtesë me katër kate (Godina 2), ku ambientet e vëna në dispozicion të procesit mësimor (auditore, laboratorë dhe zyra) ndodheshin në katin e parë (1020 m²), në katin e dytë (480 m²) dhe në katin e katërt (1200m²). Përpos këtyre ambienteve, në kontratën e qirasë përfshiheshin edhe 280 m² që ndodheshin në godinën e quajtuar Godina 1C, kati përdhes, që përdroreshin si ofiçina në ndihmë të procesit mësimor.

Sa i përket gjendjes së ambienteve, GVJ konstatoi që ato janë të bollshme, të mobiluara në funksion të përdorimit, të ajrosura dhe me ngrohje. Ambientet që përdroreshin si auditore dhe salla seminaresh ishin të bollshëm dhe të paisur me materialet e nevojshme në shërbim të procesit si psh videoprojektorë, kompjutera të lidhur në sistem, për të aksesuar materialet kudo që ato kërkoheshin. Ky sistem u verifikua që ishte funksional. Në veçanti GVJ u ndal në evidentimin e gjendjes së laboratorëve ku konstatohej ekspozimi i paisjeve në mënyrë të tillë që përdorimi i tyre të ishte sa me funksional. Konkretisht, në laboratorin e gjeodezisë, ishin ekspozuar të gjitha paisjet e instrumentet

disponues dhe të huazuar duke mundësuar tregimin e tyre të plotë dhe përdorimin e tyre të shpejtë dhe pa vështirësi. Edhe pse ambientet ishin në funksion të të gjitha programeve të studimit, nuk krijoheshin probleme në përdorimin e tyre, pasi numri i studentëve ishte i menaxhueshëm. Në përgjigje të pyetjes se si ndjeheshin studentët në këto ambiente mësuam se ata ndjeheshin të akomoduar mirë. Procesi i mësimi zhvillohej nga ora 08.00 deri në orën 15.00. Për studentët që donin të punonin jashtë këtij orari, sidomos në realizimin e detyrimeve laboratorike apo praktikës në ofiçina, institucioni krijonte mundësinë e zgjatjes së orarit.

Për të gjitha ambientet ishin marrë masat për mbrojtjen nga zjarri dhe shkarkimet elektrike duke vendosur paisjet kundra zjarrit në sallat e laboratorëve, në koridoret e kateve të përdorshme (I,II,IV), dedektorëve me ndjeshmëri të lartë ndaj zjarrit dhe instaluar 4 rufepritëse.

GVJ mësoi që KPT mbështet përpjekjet e studentëve që nuk banojnë në Tiranë për të gjetur ambiente banimi, duke u siguruar atyre akomodim në kuadrin e një kontrate që ka lidhur me administratën e Qytetit Studenti. Për problemin e ndërtimit të një ashensori, ngritur nga vlerësimet e mëparshme na u tha që puna për ndërtimin e tij ka filluar. Këtë e verifikuam gjatë vizitës në institucion

Tregues të matshëm:

- Mjediset e institucionit në funksion të programit të studimit** (Tabela 4, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Mjediset për Kolegjin (për programin e studimit)	Sasia	Sipërfaqja në m ²
Salla për leksione	5	510.05 m ²
Klasa për seminare/ushtrime	7	307.4 m ²
Salla për praktikë lëndore/ profesionale	4	284.8 m ²
Laboratorë për lëndët	6	310.8 m ²
Laboratorë informatike	4	238.6 m ²
Salla interneti		
Salla për bibliotekë	1	89.6 m ²
Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	27.4 m ²
Zyrë informacioni për studentët		
Korridore/holle		512.6 m ²
Mjedis shërbimi për të tretë 1	1	38.5 m ²
Nyje hidrosanitare për studentët	6	112.2 m ²
Ambient teknik	1	32 m ²
Shkallë		166.4 m ²
Norma m²/për student	5.17 m²/student	

Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja në m ²
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore		
Zyra për personelin akademik	6	163.07 m ²
Zyrë për financën	1	10 m ²
Zyrë për Njësinë e SBC	1	20 m ²
Salla për mbledhje		
Mjedis për stafin e shërbimit	5	134 m ²
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	1	22.2 m ²

Konkluzionet e GVJ:

Sa i përket infrastrukturës së PS, logjistikës dhe shërbimeve të tjera ndaj komunitetit, GVJ konkludon që:

- referuar numrit të studentëve- ato janë të bollshme
- referuar pajimit të tyre- janë funksionale
- referuar kushteve të punës- janë normale
- referuar perspektivës së aktivitetit- janë premtuese

Në përfundim GVJ konkludon që institucioni e **përmbush këtë standard.**

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**Pjesa përshkrimore**

Terma reference: burimet e financimit, shpenzimet, kostoja për student, kontrolli financiar, kapacitetet menaxhuese.

Në kreun VIII të statutit të KPT (aneksi 4 në DVV), neni 39 përcakton burimet e financimit të institucionit si më poshtë:

1. KPT është institucion i arsimit të lartë privat me vetëfinancim. Ai përcakton për çdo fillim viti projektbuxhetin përkatës të institucionit të ndarë në departamente, të cilin e bën sipas përcaktimeve të dhëna në këtë statut. Burimet financiare ndahen në parësore dhe dytësore.
2. Burimet parësore: Financimi nga shoqëria tregtare "KPT" shpk, ku përfshihen edhe të ardhurat nga tarifat e studimeve dhe shërbime të tjera.
3. Burimet dytësore:
 - a. Të ardhura nga shërbime që KPT ofron për të tretët.
 - b. Donacione nga sektori publik
 - c. Donacione nga sektori privat
 - d. Donacione nga shoqëria civile
 - e. Donacione nga subjekte ndërkombëtare
 - f. Projekte të aplikuara dhe fituara nga KPT
 - g. Çdo burim tjetër i ligjshëm
4. Të gjitha të ardhurat nga burimet dytësore përdoren vetëm në shërbim të institucionit.

GVJ, duke iu referuar këtij përcaktimi statutor si dhe treguesve të matshëm në RVB, gjeti që financimet për vitin 2015 janë siguruar nga tarifat e studimit **23%** dhe nga aktivitetet tregtare (menca, kafe, bare, rezidenca etj) **73%**, ndërsa për vitin 2016 financimi është realizuar **100%** nga tarifat e studimit. Në përgjigje të pyetjes lidhur me financimet, në Zyrën e Financës na u tha që edhe për vitin 2017 ato mbështeten në tarifat e studimit. Po aty mësuam edhe tarifën e studimit prej **2200 EURO** për 1 vit studimesh, mënyrën e pagimit me tre këste, përkatësisht 800, 700, 700; bonitetet që jepeshin kur pagimi bëhej njëherësh për 1 vit dhe njëherësh për dy vitet duke kursyer respektivisht 200 dhe 400 EURO.

GVJ vlerëson që shpenzimet janë bërë në funksion të aktivitetit në zërat:

- ✓ Pagat e personelit akademik e jo akademik
- ✓ Blerje të paisjeve laboratorike dhe mirmbajtje të tyre
- ✓ Blerje dhe mirëmbajtje paisjesh si kompjutera, fotokopje etj,
- ✓ Shtypje, printim dhe publikim të leksioneve të shkruara, udhëzuesve të punëve laboratorike, materiale informuese etj.
- ✓ Mirëmbajtje infrastrukture si sistemi i ngrohjes, ndriçimit etj

Duke qenë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (shpk) ky institucion u nënshtrohet të gjitha rregullave dhe legjislacionit shqiptar për shpk-të. Pra ai është subjekt kontrolli nga MASR, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) dhe Ministria e Financave (MF). Pasqyrat financiare të KPT miratohen nga mbledhja e Asamblesë së Ortakëve dhe dërgohen në Zyrën e Tatimeve dhe Rregjistrin Tregtar pranë QKB-së, çfarë siguron akses për çdo të interesuar. GVJ gjeti dhe konsultoi pasqyrat financiare për vitet financiare 2015 dhe 2016. Mbështetur në ligjin Nr. 10091 datë 05.03.2009, KPT nuk i nënshtrohet auditimit financiar. Sa i përket evidencës financiare, çdo vit hartohen raportet financiare për çdo student, raporti financiar vjetor, shpenzimet, të ardhurat dhe parashikimi për vitin e ardhshëm financiar. GVJ mësoi se hartimi i projekt buxhetit bëhet nga zyra e Financës dhe Administratori bazuar në kërkesat e departamenteve. Administratori përgatit raportin për Asamblenë e Partnerëve.

Tregues të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në vitet e fundit** (Tabela 5, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 5

Të ardhurat (në lekë) nga:	Viti 1(2015)	Viti 2 (2016)
Pushteti qendror		
Pushteti vendor		
Grantet për kërkim dhe kontratat		
Konsulencat, shërbimet		
Tarifat (regjistrim/shkollim/etj)	23%	100%
Sponsorizimet		
Tarifat për trainim (kualifikimi i vazhdueshëm)		
Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj		
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)	77%	
SHUMA	100%	

- Shpenzimet për vitet e zhvillimit të programit sipas burimit të financimit**

Siaps RVB kostoja për një student, gjatë vitit 2016-2017 është 195 680 lekë. Numri i studentëve për dy vitet 2016-2017 dhe 2017-2018 është respektivisht 15 dhe 11, nga këta 1 ishte ç'regjistruar dhe 3 ishin mbetës. Numri i pakët i studentëve dhe tendenca në rënje janë tregues të pafavorshëm për këtë PS. Në përgjigje të pyetjes: si e parashikon institucioni perspektivën e rregjistrimeve në këtë PS?, u informuam që: aktualisht shpenzimet për mbajtjen e tij përballohen nga të ardhurat e programeve të tjerë prandaj ne, duke rritur bashkëpunimin me tregun e punës, po ashtu edhe informimin lidhur me ofertën tonë parashikojmë rritje të kontigjentit. GVJ vlerëson gjithashtu se marrja e një vendimi për PS, gjykuar vetëm me dy vite aktivitet, nuk është në dobi të institucionit. Institucioni në planifikimin e financimeve, sipas rektorit KPT, niset nga filozofia: Investim duke analizuar nevojat dhe perspektivën.

- Kosto e studimit/për student për një vit akademik**

Ky tregues ishte tregues i institucionit. Sipas RVB kostoja për një student në KPT është 195 680 lekë. Për PS “Gjeodezi” ku numri i studentëve është 25, për të dy vitet e studimit, dhe ku shpenzimet vetëm për paisjet dhe instrumentat arrijnë shuma të konsiderueshme, nuk kishte të dhëna.

Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL , gjatë vizitës

Në zyrën e Financës na u dhanë vetëm shifrat e paraqitura më lart dhe jo dokumentacion.

Konkluzionet e GVJ:

Shpenzimet për PS “Gjeodezi”, për shkak të nevojave akoma të pa plotësuara për bazën laboratorike dhe numrit të pakët të studentëve që e frekuentojnë, janë më të larta se kostot instucionale për student.

Nga pikpamja financiare, referuar 2 viteve të para, mbajtja e këtij programi studimi është me humbje.

Por mbështetur në mënyrën e krijimit dhe përdorimit të mjeteve financiare si dhe ecurisë së deritanishme të procesit mësimor në këtë institucion, GVJ konkludon që ai i **përmbush standardet lidhur me financimin dhe menaxhimin e burimeve financiare.**

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, në funksion të programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Funksionimi i Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJBSC), i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Për të gjykuar mbi ndërtimin dhe funksionimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë në KPT, GVJ i referohet RVB-së, anekseve shtesë të DVV (konkretisht aneksi 6 “Statutit”, referuar nenit 11 ku përcaktohet “Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë” si dhe aneksit 15 “Rregullorja e NJBSC-së” ku përcaktohen detyrat e njësisë), informacioneve të marra gjatë takimit në institucion me përgjegjësen e NJSBC si dhe produkteve të prodhuara nga kjo Njësi.

Në këtë kuadër, GVJ konkludon që NJBSC është ngritur në formën e një ekipi të përbërë nga pedagogë që përfaqësojnë departamentin e EMSA, një student dhe një ekspert i jashtëm në zbatim të detyrave si më poshtë:

- Kontrolli i procesit mësimor
- Kontrolli i mënyrës së organizimit të mësimdhënjes
- Kontrolli i hartimit të syllabuseve
- Kontrolli i mënyrës së hartimit të tezës së provimit dhe vlerësimit të studentëve.

Për programin e Studimit “Gjeodezi” kjo njësi ka funksionuar për vitin 2016-2017.

Në takimin me përgjegjësen e NJSBC, GVJ mësoi që kontrollat kryhen në mënyrë periodike dhe mbi bazën e tyre hartohen raporte të cilat i dërgohen Rektorit. Konkretisht u informuam për kontrollin e syllabuseve, i cili ishte ushtruar për të konkluduar mbi praninë e përsëritjeve të temave në lëndë të ndryshme, mënyrën e shpërndarjes së temave si dhe strukturimin e gruplëndëve. Po kështu, kjo Njësi organizonte kontrollin e pedagogëve të rinj 1 herë në semestër. Vlerësimi i pedagogëve nga studentët bëhej në javën e 12 apo 13, duke gjykuar që në këtë periudhë studentët kanë përvojë të mjaftueshme për të dhënë gjykime sa më objektive. Në vazhdim u informuam edhe për kontrollat e ushtruara për provimet (përgaditjen e tezave, kontrollin e përgjigjeve, objektivitetin e vlerësimeve etj). Sa i përket procesit mësimor, GVJ u informua lidhur me gjetjet e NJBSC për angazhimin e një pedagogu në disa lëndë, kriteret që vendosen në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënjes nga studentët, marrëdhëniet e

njesisë me tutoriatin, ndikimin e gjetjeve të NJSBC në vendimmarrje si dhe mënyrën e përpunimit e vlerësimit të informacioneve të marra. Në përgjigje të këtij interesimi, GVJ gjykon që NJSBC në këtë institucion është aktive dhe ndikimi i aktivitetit të saj në sigurimin e brendshëm të cilësisë është i matshëm.

Tabela 6

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Antoneta Deda	Kryetare	Dhjetor 2016- në vazhdim
2	Ervin Suli	Anëtar	Dhjetor 2015- në vazhdim
3	Teuta Halilaj	Anëtare	Dhjetor 2015- në vazhdim
4	Jola Osmënaj	Anëtare	Dhjetor 2016- në vazhdim
5	Beniamin Disha	Student	Dhjetor 2017- në vazhdim
6	Odeta Cati	Ekspert i jashtëm	Dhjetor 2015- në vazhdim

Tregues të matshëm:

- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel programi studimi**
- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre**
- Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike**
- Rezultatet e auditimit dhe vlerësimeve të jashtme**

Për të gjitha pikat e mësipërme mendojmë se:

NJBSC në aktivitetin e saj ka realizuar praktikisht kontrole në gjithë spektrin e kompetencave të saj. Krahas këtyre ajo ka organizuar e realizuar edhe anketimet e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, mënyrën e shpjegimit të pedagogëve gjatë leksioneve, mënyrën e organizimit të seminareve dhe laboratorëve, etikën e komunikimit me studentët, mënyrën e menaxhimit të kohës së vënë në dispozicion për sejcilin nga komponentët e mësimdhënies, qartësinë e formulimit të tezave të provimit, objektivitetin në vlerësimin e përgjigjeve, angazhimin për të plotësuar mungesat e konstatuara në plotësimin e detyrimeve etj. Në takimin e zhvilluar me Përgjegjësen e NjBSC u informuam që hartimi i pyetorit mbështetej kryesisht në eksperiencën e grupit të njesisë si dhe në bashkëpunimin me tutoriatin. Këto anketime kryheshin në çdo fund semestri (java 12-13). Secili student kishte plotësuar formularin e tij në mënyrë anonime duke u fokusuar në lëndën konkrete.

Pas plotësimit të formularëve, të dhënat e tyre ishin sistemuar në tabela për tu përpunuar më tej nga sekretaria e departamentit. Interesimit të GVJ lidhur me problemet e dala për PS “Gjeodezi” nga këto intervistime, përgjegjësja e NJBSC iu përgjigj që, deri tani nuk janë evidentuar probleme që të konsiderohen. Këtë pohim e konstatuam edhe gjatë konsultimit të aneksit 16 “Raportet e NjBSC” si dhe materialeve që na u vunë në dispozicion nga institucioni. Edhe në takimin me studentët, ku nuk merrnin pjesë pedagogët, pyetja e GVJ lidhur me shqetësimet që kanë patur ata për ecurinë e procesit mësimor rezultoi të jetë: nuk kemi patur shqetësime për t’u konsideruar.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL , gjatë vizitës**

Interesimit të GVJ për të marrë dokumenta plotësuese lidhur me aktivitetin e NjBSC, zyra përkatëse iu përgjigj duke në vënë në dispozicion:

- Relacione mbi vlerësimin e studentëve për pedagogun dhe lëndën e(Sashenka Avrami)
- Relacione për zhvillimin e kontroleve gjatë zhvillimit të provimeve

- Formular për vlerësimin e pedagogut nga kolegu i tij dhe firmosur nga përgjegjësi i Departamentit
- Raporte mbi kontrollin e syllabuseve.

Konkluzionet e GVJ:

Bazuar në dokumentacionin egzistues lidhur me aktivitetin dhe produktet e NJBSC në departamentin e EMSA, në vartësi të të cilit është PS “Gjeodezi”, GVJ konstaton që ky aktivitet është kryer konform dispozitave ligjore dhe rregulloreve përkatëse. Produktet e këtij aktiviteti kanë ndikuar në mbajtjen gjallë të frymës së kontrollit, kryesisht të punës së personelit akademik si dhe respektimit të detyrimeve kontraktuale si nga ana e tij ashtu edhe institucionit. Pyetësorët janë hartuar me pyetje të mbyllura , por edhe me një pyetje të hapur. Rezultatet janë përpunuar nga NJBSC. Në përgjithësi rezultojnë mendime shume pozitive për stafin akademik.

Si rrjedhojë e këtyre gjetjeve, GVJ konkludon që institucioni i **përmbush standarde lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë.**

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit “Gjeodezi” është në vartësi të Departamentit të Elekromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara (EMSA). Ai është hapur për herë të parë ne vitin akademik 2016-2017 duke arritur një kuotë rregjistrimesh prej 15 studentësh për të vazhduar në vitin 2017-2018 me 11 studentë. Kurrikula e këtij PS përfshin 21 lëndë të klasifikuara sipas gjurmës që lënë në formimin e studentëve në : lëndë të formimit bazë (A), të formimit karakterizues (B), të ngjashme/integruese (C), lëndë me zgjedhje (D) dhe lëndë formuese për njohjen e gjuhës së huaj, informatikës dhe praktika mësimore (E). Në realizmin e kurrikulës mësimore janë angazhuar 16 pedagogë nga të cilët 7 janë personel akademik efektiv (PAE) dhe 9 janë personel akademik me kontratë (PAK). Kurrikula ka pësuar disa ndryshime pas vitit të parë. Këto ndryshime jepen në RVB dhe konsistojnë në:

1. Zëvendësimin e lëndës “Gjeografi” si lëndë jo specifike për këtë PS me lëndën “Aplikime të gjeodezisë në ndërtime” që është lëndë karakterizuese për të.
2. Bashkimin e dy lëndëve të afërta pa cënuar programet e tyre, pasi zhvillimit të syllabuseve të tyre u mjaftonin 6 kredite nga 12 që ishin parashikuar në variantin e parë.
3. Rivlerësimin e krediteve duke marrë në konsideratë syllabuset konkrete të lëndëve.

Në analizë, konstatohet që këto ndryshime, të bëra nga stafi akademik referuar kurrikulës së hartuar para hapjes së programit, e përmirësojnë strukturën e saj sepse:

Së pari, janë ndërmarrë nga një personel i cili ka përvojë pune si në fushën e matjeve ashtu edhe në atë të mësimdhënies

Së dyti, lëndët janë përshtatur më mirë me misionin dhe objektivat e institucionit duke shfrytëzuar dhe stafet e përbashkëta të programeve të tjera të studimit.

Së treti, është rritur pesha e praktikës profesionale dhe temës/provimit të formimit.

Tregues të matshëm:

Organizimi i programit të studimit (në vite/semestra/javë)

- Programi shtrihet në dy vite akademike me një volum prej 120 kreditesh ECTS.
- Numri i semestrave është 4. Çdo semestër ka mesatarisht 30 kredite.
- Nje kredit ECTS ka 25 orë punë studenti
- 1 orë mësimore zgjat 60 minuta

Shënim: Nga analiza e tab 7 rezulton që:

- semestri i parë ka 31 kredite
- semestri i dytë 30 kredite
- semestri i tretë 30 kredite
- semestri i katërt 29 kredite

Raporti teori/ushtrime/laborator në kredite është **48/36/36**, që në % shprehet **40%/30%/30%** ose raporti teori/ praktikë është afërsisht **40% / 60%**.

Emërtimi i Diplomës:

Diplomë profesionale dy vjecare në “Gjeodezi”

Plani mësimor

Plani mësimor i PS “Gjeodezi” jepet në tabelën 7(sipas planit mësimor që IAL ka paraqitur në RVB)

Lënda	Semestri	ECTS	Orë javë	Orë mësimore													
				Leksione			Ushtrime			Laborator/ praktika			Orë në auditor	Punë e Pavarur	Gjithsej	Provine	
				ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur					
1	Matematikë	I	4	3	2	14	36	2	24	26				38	62	100	2
2	Anglisht	I	4	3.5				4	48	52				48	52	100	3
3	Fizikë e përgjithshme	I	5	4.5	2	14	36	2	24	26	1	21	4	59	66	125	1
4	Vizatim teknik e AutoCad	I	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1
5	Hyrje në teknologji informacioni	I	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1
6	Gjeodezi 1	I	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1
7	Teknologji ndërtimi	II	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1
8	Gjeodezi 2	II	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1
9	Hartografi	II	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1
10	Topografi dhe rilevim	II	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1
11	Praktikë në terren	II	6	5	2	14	36				4	84	16	98	52	150	1
12	Gjeodezi 3	III	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1
13	Aplikime të	III	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1

	gjeodezisë në ndërtim																
14	Aplikacione të gjeoshkencës	III	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1
15	Menaxhimi i punimeve në kantier	III	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1
16	Bazat e sipërmarrjes	III	6	5	4	28	72	2	24	26				52	98	150	1
17	Teori gabimi, koregjimi e optikë e aplikuar	III	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1
18	Përpunim imazhi	IV	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1
19	Rrjete gjeodezike	IV	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1
20	Praktikë profesionale	IV	10	6							10	210	40	210	40	250	1
21	Tema/Provim formues	IV	7								7	147	28	147	28	175	1
Total			120		52	367	915	38	432	466	30	711	109	1510	1490	3000	

Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licensuara (Tabela 8, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës).

Tabela 8

Lënda	Semestri	ECTS	Orë javë	Orë mësimore														
				Leksione			Ushtrime			Laborator			Orë në auditorium	e Pavarur	Gjithsej	Provine		
				ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur						
1	Gjeografi (Ishte)	III	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1	
	Aplikimet e gjeodezisë në ndërtim (Futet e re me zëvendësim)	III	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1	
2	Organizimi i punëve në Kantier (Ishte)	III	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1	
	Menaxhimi i punëve në kantier (Riemërim)	III	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1	
3	Aplikacione të gjeoshkencës (GPS) (Ishte)	III	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1	
	Aplikacione të gjeoshkencës (GIS) (Ishte)	III	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1	
	Aplikacione të gjeoshkencës (GPS, GIS) (Bashkim)	III	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1	
4	Nuk ishte		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
	Hyrje në teknologjinë e informacionit (Futet e re)	I	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1	
5	Matematikë (Ishte)	I	6	5	3	21	54	2	24	26	0	0	0	66	84	150	1	
	Matematikë (Bëhet)	I	4	3	2	14	36	2	24	26	0	0	0	38	62	100	1	
6	Fizikë e përgjithshme (Ishte)	I	6	5	3	21	54	2	24	26	0	0	0	66	84	150	1	
	Fizikë e përgjithshme (Bëhet)	I	5	4.5	2	14	36	2	24	26	1	21	4	59	66	125	1	
7	Anglisht (Ishte)	I	5	4.5				5	60	65				60	65	125	1	
	Anglisht (Bëhet)	I	4	3.				4	48	52				48	52	100	1	

				5												
8	Praktikë profesionale (Ishte)	IV	6						6	126	24	126	24	150	1	
	Praktikë profesionale (Bëhet)	IV	10						10	210	40	210	40	250	1	
9	Tema/Provim Formimi (Ishte)	IV	6						6	126	24	126	24	150	1	
	Tema/Provim Formimi (Bëhet)	IV	7						7	147	28	147	28	175	1	
Ndryshime në total			5													

Kuadri i përgjithshëm formues i Programit të studimit (Tabela 9, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 9

Tipi i Veprimtarisë (A-F)	Lënda/Moduli	Kreditet	Totali
Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A)	Matematikë	4	15
	Fizikë e përgjithshme	5	
	Vizatim teknik e AutoCad	6	
Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B)	Teknologji ndërtimi	6	48
	Gjeodezi 1	6	
	Gjeodezi 2	6	
	Hartografi	6	
	Përpunim imazhi	6	
	Aplikacione të gjeoshkencës (GPS, GIS)	6	
	Rrjete gjeodezike	6	
	Aplikime të gjeodezisë në ndërtime	6	
Veprimtari në disiplina të Ngjashme dhe/ose integruese (C)	Teori gabimi, koregjimi e optikë e aplikuar	6	18
	Topografi dhe rilevim	6	
	Gjeodezi 3	6	
Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D)	Bazat e sipërmarrjes	6	6
	Menaxhimi i punimeve në kantier	6	
Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika (E)	Hyrje në teknologji informacioni	6	26
	Anglisht	4	
	Praktikë në terren	6	
	Praktikë profesionale	10	
Provim përfundimtar (F)	Tema/Provim formues	7	7
			120

Vlerësimi i Syllabus-eve nga ana cilësore.

Syllabuset janë hartuar për cdo lëndë dhe përbëhen nga këto elementë:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit (ndarja A-F)
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës (nëse ka)
- Objektivat e lëndës, çfarë njohurish dhe aftësish synon të japë kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

GVJ i shqyrtoi të gjitha sylabuset e lëndëve që përfshihen në kurrikulën e PS “Gjeodezi” dhe që disponohen si Aneksi 7 i DVV, dhe gjeti që hartimi i tyre është bërë sipas formatit të kërkuar. Nga ana formale u konstatua mungesa e përcaktimit të karakterit formues të lëndës sipas klasifikimit nga A në F. Po ashtu tek paragrafi ushtrime, në shumicën e syllabuseve është shënuar: “Ushtrimet mbulojnë gjithë gamën e problemeve në përputhje me programin e lëndës”, ndërkohë që mund të listoheshin tipe të grupuara ushtrimesh. Sa i përket përmbajtjes së tyre, GVJ vlerëson se ata e japin të plotë problematikën e lëndës duke iu përgjigjur objektivave të saj. Duke gjykuar që syllabuset janë në proces përmirësimi të vazhdueshëm rekomandojmë përshtatjen e tyre sipas kërkesave të tregut, zhvillimit të teknologjisë, propozimeve e sugjerimeve të studentëve etj

- Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës** (Tabela 10, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 10

Lënda /Moduli		Pedagogu/ Pedagogët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti ku është me kohë të plotë	Ngarkesa mësimore (orë)	Statusi PAE apo PAK
1	Matematikë	Shpëtim Bozdo Ervin Suli	Prof.Dr. Msc.	Teknologji e Informacionit	38	PAE PAE
2	Anglisht	Petro Plasa		Teknologji e Informacionit	48	PAE
3	Fizikë e përgjithshme	Antoneta Deda Teuta Halilaj Idajet Selmani	Prof.Dr. Msc. Msc.	Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	59	PAE PAE PAK
4	Vizatim teknik e AutoCad	Luisa Dhimitri	Msc.	Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	66	PAK
5	Hyrje në teknologji informacioni	Illir Shinko Esmeralda Bërdufi	Dr. Msc.	Teknologji e Informacionit	66	PAK PAK
6	Gjeodezi 1	Sashenka Avrami	Msc.	Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	66	PAE
7	Teknologji ndërtimi	Luisa Dhimitri	Msc.	Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	66	PAK
8	Gjeodezi 2	Përparim Lika	Dr.	Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	66	PAK
9	Hartografi	Sashenka Avrami	Msc.	Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	66	PAE
10	Topografi dhe rilevim	Pren Muça	Msc.	Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	66	PAK
11	Praktikë në terren	Pren Muça Emiliano Qose	Msc. Msc.	Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	98	PAK PAK
12	Gjeodezi 3	Genc Salja	Msc.	Elektromekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	66	PAK
13	Aplikime të	Pren Muça	Msc.	Elektromekanikës dhe	66	PAK

	gjeodezisë në ndërtim			Sisteme të Aplikuara		
14	Aplikacione të gjeoshkencës (GPS, GIS)	Genc Salja Emiliano Qose	Msc. Msc.	Elektromekanikës dhe Sisteme të Aplikuara	66	PAK PAK
15	Menaxhimi i punimeve në kantier	Luisa Dhimitri	Msc.	Elektromekanikës dhe Sisteme të Aplikuara	66	PAK
16	Bazat e sipërmarrjes	Erion Curraj Anisa Curraj	Msc. Msc.	Teknologji e Informacionit	52	PAE PAK
17	Teori gabimi, koregjimi e optikë e aplikuar	Sashenka Avrami	Msc.	Elektromekanikës dhe Sisteme të Aplikuara	66	PAE
18	Përpunim imazhi	Emiliano Qose	Msc.	Elektromekanikës dhe Sisteme të Aplikuara	66	PAK
19	Rrjete gjeodezike	Sashenka Avrami	Msc.	Elektromekanikës dhe Sisteme të Aplikuara	66	PAE

Nga Tabela rezultojnë se: Sashenka Avrami angazhohet në 4 lëndë, dhe Pren Muça angazhohet në 3 lëndë.

Vlerësimi sipas standardeve:

Standardi 6: Struktura e programit, rezultatet e të mësuarit dhe proceset e vlerësimit të mësimdhënies janë në përputhje me standardet evropiane.

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Programi është në përputhje me Bolonjën, Përshkruesit e Dublinit dhe Kornizën Evropiane të Kualifikimeve.

Kriteri 2 Studentët janë të pajisur me Suplementin e Diplomës që përputhet me rregulloret e BE-së për diplomim

Kriteri 3 Arritjet në nivelin 4 në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, lejojnë regjistrimin në këtë program studimi

Kriteri 4 Studentëve të regjistruar me formim dhe njohuri të ndryshme nga prurjet e zakonshme (jo tradicionalë) u ofrohet mbështetje e duhur që në fazat e hershme të programit.

Kriteri 5 Programit ka 120 ECTS dhe lejon transferimin në vitin e 3, të një programi bachelor.

Kriteri 6 Ka një raport të balancuar 50:50 praktikë / teori në programin mësimor, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimin e studentëve.

Kriteri 7 Rreth 25% e programit është i vendosur në punë konkrete (p.sh. në një semestër ose i vendosur në pushimet e verës) ose në shkëmbime ndërkombëtare (p.sh. Erasmus +).

Kriteri 8 Mësimi praktik dhe elementëve të punës konkrete u është dhënë pesha e duhur në vlerësim dhe rivlerësim.

Vlerësimi sipas standardit 6:

Referuar RVB, anekseve të DVV si dhe vizitave në institucion, GVJ konkludon që programi i studimeve "Gjeodezi" e zhvillon aktivitetin e tij në përputhje me Kartën e Bolonjës, Përshkruesit e Dublinit dhe Kornizën Evropiane të Kualifikimeve. Kurrikula e tij është hartuar në mënyrë të tillë që t'u transmetojë studentëve njohuri bazë, karakterizuese të profesionit, të ngjashme përkatësisht integruese, njohuri të preferuara në kuadrin e profesionit si dhe aftësi për shfrytëzim literature në gjuhë të huaj, njohuri e aftësi për të punuar me teknologjinë kompjuterike, shprehi

praktike në realizimin e proceseve që çojnë tek produktet vetiake etj. Ai siguron mobilitetin e studimeve dhe i aftëson studentët për të hyrë sa më shpejt në tregun e punës. Programi i plotëson të gjitha kërkesat e legjislacionit për arsimin e lartë.

Programi i studimeve “Gjeodezi” është hapur për herë të parë në vitin 2016-2017. Këtë vit akademik (2017-2018) studentët e këtij programi janë akoma në proces duke ndjekur kurrikulën e planifikuar për semestrin e tretë të studimeve. GVJ u interesua lidhur me dokumentacionin e çertifikimit të studimeve dhe mësoi që suplementi i diplomës, kartoni i diplomës si dhe lista e notave do të lëshohen në përputhje me rregulloret e BE dhe dispozitat ligjore të arsimit të lartë, kur studentët të kenë përfunduar me rezultat pozitiv mbrojtjen e diplomës dhe të kenë shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj institucionit.

Sa u përket kriterëve që duhen përmbushur lidhur me rregjistrimet në KPT (pra edhe në PS “Gjeodezi”) ato janë hartuar për t’iu përgjigjur minimalisht arritjeve në nivelin 4 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Për t’u rregjistruar në KPT, kandidatët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm 3 ose 4 vjeçar sipas sistemit të ri përkatësisht vjetër apo profesional me kohëzgjatje 5 vjet si dhe të kenë përfunduar me rezultat pozitiv maturën shtetërore (cilësia e notes nuk është kriter). Pranohen edhe kandidatë/studentë që kanë ndjekur studimet jashtë vendit dhe paraqesin një diplomë të vlefshme, e cila njihet në kuadrin e legjislacionit ekzistues apo një diplomë universitare të fituar në një institucion të arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit dhe kërkojnë ta ndjekin PS si program të dytë studimi.

Mbështetja që u ofrohet studentëve, të cilët nuk janë prurje të zakonshme psh vijnë nga studimet bachelor ose nga nivelet e tjera jo universitare të natyrës profesionale, dhe duan ti riorientojnë studimet e tyre, lidhet me njohjen e krediteve të lëndëve të njëjta ose të ngjashme. Ky proces kryhet në nivel departamenti. Në përvojën e deritanishme të PS “Gjeodezi” nuk kishte as studentë të ardhur si prurje jo të zakonshme as studentë të larguar për të ndjekur një program tjetër studimi jashtë KPT. Gjatë takimit me studentët, në përgjigje të pyetjes sonë lidhur me dëshirën për t’i transferuar studimet, pati një studente që shprehu dëshirën të vazhdonte studimet në universitet pasi të mbaronte studimet në KPT. Shpjegimet tona ishin të njëjta me ato që i ishin dhënë edhe nga stafi i KPT, çfarë tregon që informimi për studentët lidhur me transferimet është funksional.

Edhe programi i studimeve “Gjeodezi”, si gjithë programet e tjera të KPT, zgjat 2 vjet dhe përmban 120 kredite. Njësoj si në programet e studimeve universitare edhe në KPT, çdo semestër ka 30 kredite. Ky strukturim është bërë në përmbushjeve të kërkesave ligjore për organizimin e studimeve në arsimin e lartë me qëllim që të mundësohet mobiliteti i studimeve, pra kalimi i tyre nga një IAL në një tjetër. Në këtë kuadër edhe studimet në KPT mund të kalohen në studime universitare (diploma Bachelor) pasi të bëhet ekuivalentimi i kreditëve nga institucioni pranues. Pra, të drejtën e pranimi e ka institucioni ku studenti dëshiron të transferojë studimet. Duke krahasuar kurrikulën e PS “Gjeodezi” me kurrikulën e studimeve “Bachelor” në universitet gjeokojmë që mundësia e transferimit ekziston.

Për të gjykuar mbi raportin teori/praktikë, GVJ konsultoi dokumentacionin ekzistues duke u ndalur veçanërisht tek shpërndarja e ngarkesës (Tab. 7) ku rezulton që raporti teori/ushtrime/laborator në kredite është 48/36/36, e cila në % shprehet, 40%/30%/30% çfarë do të thotë se raporti teori/ praktikë është **40% / 60%**, ndërkohë që ngarkesa e plotë, pra duke përfshirë edhe punën e pavarur në leksione, ushtrime dhe laborator rezulton e balancuar 50/50.

Për vetë natyrën e profesionit, studentët e programit të studimeve “Gjeodezi” mund të punojnë edhe gjatë stinës së verës. Për këtë, institucioni duhet të nënshkruajë marrveshje bashkëpunimi me subjektet private duke i angazhuar ato edhe në monitorimin e masës së realizimit të programit

(25%). GVJ konstatoi që Institucioni kishte lidhur marrveshje vetëm me një subjekt privat në fushën e gjeodezisë (Gjeo-Vjosa Shpk) ku studentët mund të aktivizohen për të kryer praktikën apo punë të pavarur por rekomandon lidhjen e kontratave edhe me subjekte të tjerë, çfarë do ndikonte pozitivisht jo vetëm për rritjen e mundësive për aktivitet praktik gjatë kohës së studimeve por edhe për punësimin pas përfundimit të studimeve. Sa i përket shfrytëzimit të shkëmbimeve ndërkombëtare për këtë qëllim, në stadin e deritanishëm nuk kishte ndonjë realizim.

Duke gjykuar raportin teori praktikë në tërësi për programin e studimit si dhe duke e shqyrtuar shpërndarjen e ngarkesës në leksione, seminare/ushtime dhe punë laborator konkludohet që mësimi praktik dhe elementëve të punës konkrete u është dhënë pesha e duhur. Treguesit e matshëm si raportet e aktivitetit në auditor midis leksioneve, ushtimeve dhe laboratorëve përkatësisht 40%/30%/30% e konfirmojnë këtë. Ky raport është përmirësuar më tej me ndryshimet e bëra në kurrikulën e programit.

Konkluzionet e GVJ:

Lidhur me plotësimin e standardit 6, duke shqyrtuar plotësimin e seicilit prej kriterëve që e përbëjnë atë, konkludohet që:

- Programi i studimeve “Gjeodezi” e zhvillon aktivitetin e tij në përputhje me Kartën e Bolonjës, Përshkruesit e Dublinit dhe Kornizën Evropiane të Kualifikimeve si dhe në plotësim të kërkesave të legjislacionit shqiptar për arsimin e lartë.
- Institucioni është përgaditur për paisjen e të diplomuarve të këtij PS me të gjitha dokumentet që e çertifikojnë atë: Diplomën, Listën e Notave dhe Suplimentin e Diplomës në përputhje me rregulloret e BE-së.
- Rregjistrimi i studentëve në programin e studimeve “Gjeodezi” bëhet konform kriterëve të përcaktuara në dokumentat bazë të funksionimit të institucionit: Statutin (Aneksi 4) dhe Rregulloren e Programit të Studimit (Aneksi 6), të cilat janë hartuar në përputhje me dispozitat ligjore për arsimin e lartë
- Për studentët që nuk janë prurje e zakonshme e KPT ofrohet trajtim i posaçëm në drejtim të njohjes dhe ekuivalentimit të krediteve. Në PS “Gjeodezi” derimëtani nuk ka patur ndonjë rast konkret, prandaj sa më sipër e vlerësojmë si mundësi.
- Lidhur me mundësinë e kalimit të studimeve nga viti i dytë i këtij PS tek viti i tretë i diplomës Bachelor gjykohet që kjo mundësi ekziston. Raste konkrete nuk ka patur por, përderisa baza ligjore e parashikon këtë, realizimi i saj shihet thjesht si një procedurë administrative.
- Në këtë program studimesh raporti teori/praktikë në auditor është në favor të praktikës, ndërsa duke përfshirë dhe punën e pavarur ai është i balancuar.
- Lidhja e marrveshjeve të bashkëpunimit me subjektet private e mundëson realizimin e programit në masën 25% edhe gjatë semestrit por edhe gjatë stinës së verës. *GVJ gjykon që ekzistenca vetëm e një marrveshje me subjektet private është pak prandaj rekomandon zgjerimin e këtij bashkëpunimi.* Sa i takon shfrytëzimit të shkëmbimeve ndërkombëtare për realizim të programit të studimeve nuk kishte ndonjë rast.
- Kriteri 8 i këtij standardi plotësohet në masën e kërkuar.

Përfundimisht GVJ konfirmon **plotësimin e standardit 6.**

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njesisë etj.

Edhe në programin e studimeve “Gjeodezi” mësimdhënia organizohet në format tradicionale të saj, pra në kompozitën leksione/seminare përkatësisht ushtrime/ laboratore. Numri i orëve të mësimi llogaritet mbi bazën e krediteve të specifikuar për çdo njëerën nga tri komponentet e mësipërme dhe përcakton përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve. Për studentin ngarkesa shpërndahet si ngarkesë në auditor dhe si punë e pavarur. Një orë mësimi në auditor zgjat 60 minuta. Ngarkesa mësimore e një pedagogu pa titull është 360 orë mësimore. Metodatat e mësimdhënies kushtëzohen kryesisht nga komponenti (leksione, ushtrime, laboratore) por edhe nga natyra e programit të studimeve, ndërsa organizimi i kohës edhe nga numri i studentëve. Në programin e studimeve “Gjeodezi” numri i studentëve është 15 për vitin e dytë dhe 11 për vitin e parë. Ky numër është i favorshëm për krijimin e kushteve optimale lidhur me ambientin, mjetet didaktike, aktivizimin, kontrollin dhe kohëzgjatjen gjatë operimeve për të kryer punët laboratorike. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi që leksionet zhvilloheshin në ambiente të përshtatshme ku shpjegimi realizohej si me mënyrën tradicionale ashtu edhe me përdorimin e videoprojektorit dhe programit PowerPoint.

Studentët i vlerësonin shpjegimet si të kuptueshme dhe nuk paraqitën ndonjë vërejtje lidhur me to. Edhe ushtrimet ishin në funksion të konkretizimit të njohurive të fituara gjatë leksioneve duke e vënë studentin jo vetëm në kushtet e riprodhimit por edhe në ato të kreativitetit. Punët laboratorike, në përputhje me natyrën e këtij profesioni kryheshin kryesisht në terren. Studentëve u kërkoheshin të vepronin praktikisht për centrimin, horizontimin dhe orientimin e instrumentava matës duke u bërë të njohur atyre fillimisht pjesët përbërse dhe funksionimin e tyre dhe pastaj realizimin e metodikave dhe krijimin e bazës së të dhënave. Për përvetësimin e njohurive, studentëve u viheshin në dispozicion leksionet e shkruara, ushtrimet e zgjidhura, udhëzuesit për punët e laboratorit si dhe literatura. Nga ana e stafit akademik të programit të studimeve, studentëve u ofroheshin konsultime lidhur me problemet që ata hasnin gjatë përvetësimit të materialeve si dhe bëheshin vlerësime të ndërmjetme për aktivizimin e tyre, të cilat konsideroheshin në masën 10% në vlerësimin përfundimtar. Po kështu në vlerësimin përfundimtar konsiderohej edhe realizimi i punëve laboratorike në masën 30%, ndërkohë që provimi i lëndës e përcaktonte në masën 60% rezultatin e vlerësimit. Për të hyrë në provimin përfundimtar studentët duhet të kishin frekuentuar leksionet në masën 60%, ushtrimet në masën 60% dhe punët laboratorike në masën 80%. Për nxjerrjen e problematikave gjatë procesit mësimor, ky monitorohet nga tutorati, i cili punon ngushtësisht me përgjegjës të departamentit dhe rektorin dhe kontribuon në marrjen e masave përkatëse për mbarëvajtjen e vazhdueshme të procesit. Sa i përket aktivizimit të studentëve në ndihmë të mësimdhënies konstatohet pjesmarrja e njërës prej tyre në NJBSC si dhe vlerësimi i mendimeve të tyre të shprehura në anketimet që zhvillohen nga NJBSC-ja. Po kështu aktivizimi i studentëve është i plotë gjatë kryerjes së praktikave por, mungon si kontribut në punimet individuale të pedagogëve, për projekte/praktika në rang Departamenti si dhe për projekte në bashkëpunim me të tjerë.

Tregues të matshëm:

- Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies në programin e studimit,**
(Tabela 11, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 11

Programi i Studimit jouniversitar 2 vjeçar në Teknologji Automjetesh	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	343
Seminare /Ushtime	432
Laboratore	378
Praktikë profesionale	210
Në total	1363

Nga analiza e orëve mësimore rezulton se në përqindje, raporti ndërmjet tyre është: **25 %/ 31.6 %/ 28 % / 15.4 %**. Pra rreth 70% janë orë në praktikë.

- Format e kontrollit të njohurive** (Tabela 12, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 12

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratore, detyra kursi, praktika)	30%
Provim përfundimtar	60%
Në total	100%

Kjo ndarje ka funksionuar dhe është ndjekur nga të gjithë pedagogët. Për këtë u vëzhguan procesverbalet në sekretarinë e shkollës.

- Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njesisë jashtë procesit mësimor** (Tabela 13, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 13

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për praktika në rang Program Studimi	15
Për punime individuale të pedagogëve	Nuk ka
Për projekte/praktika në rang Departamenti	Nuk ka
Për projekte në bashkëpunim me të tjerë	Nuk ka

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Studentët në Programin e Studimeve “Gjeodezi” në KPT janë rregjistruar në dy vite studimesh: në vitin 2016-2017 janë rregjistruar 15 studentë nga ku 1 është ç’rregjistruar, dhe në vitin 2017-2018 janë rregjistruar 11 studentë. Pranimi i tyre është bërë në kushtet e plotësimit të nivelit të 4 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe dokumentat bazë të funksionimit të institucionit: Statutin, Rregulloren e IAL dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Realizimi konkret i pranimit është kryer nëpërmjet aplikimit online në faqen zyrtare të Maturës Shtetërore. Ky proces është kontrolluar nga Agjensia Kombëtare e Provimeve dhe MASR në përputhje me dispozitat ligjore, konkretisht udhëzimin nr. 13 datë 22.07.2016 “Për procedurat e aplikimit dhe të rregjistrimit në programet e studimit të ciklit të parë të studimeve, në programet e studimit me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë në institucionet e arsimit të lartë në vitin 2016-2017” si dhe udhëzimit nr. 18, datë 16.08.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 15, datë 19.05.2017 “ Për procedurat e aplikimit dhe të rregjistrimit në programet e studimit të ciklit të parë të studimeve, në programet e studimit me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë në vitin akademik 2017-2018”. Në të dy vitet, pas përfundimit të aplikimeve Agjensia Kombëtare e Provimeve ka dërguar në institucion listën e studentëve që kishin fituar të drejtën për të ndjekur PS “Gjeodezi”. Në KPT, pra edhe në këtë PS, pranimi bëhet pa kriterin e notës mesatare. Koha e zgjatjes së studimeve është dy vjet. Frekuentimi është i detyrueshëm në masën 60% të leksioneve e ushtrimeve dhe në masën 80% për laboratorët. Nga 15 studentët e rregjistruar në vitin 2016-2017 rezultonte 1 student i ç’rregjistruar dhe 3 studentë mbetës. Diplomimi i 11 studentëve të tjerë bëhet në qershor- korrik të këtij viti. Këtej do dalin dhe të diplomuarit e parë të këtij PS. Të gjithë informacionin lidhur me PS, studentët e merrnin edhe në formën e formateve fizike: guida, rregullore, fletë palosje, njoftime të shpallura në mjediset e kolegjit si orari i mësimëve, fragmente rregulloresh etj. por edhe në formatet elektronike, duke përdorur për këtë qëllim faqen e internetit si dhe programin Classter, funksionimi i të cilit u verifikua edhe nga GVJ. Ecuria e studentëve në procesin mësimor dokumentohej në dokumentacionin që iu vu në dispozicion GVJ gjatë vizitës së tij tek Zyra e Burimeve Njerzore. GVJ shqyrtoi “Rregjistrin Themeltar të Studentëve” dhe “Rregjistrin e Matrikulimit”. Në këto rregjistra gjendeshin të gjitha të dhënat e studentëve si dhe marrëdhënia e tyre me institucionin. Plotësimi i tyre ishte konform kërkesave ligjore. U kontrolluan në mënyrë rastësore edhe dy dosje dokumentacioni të studentëve dhe në to u gjetën dokumentat si më poshtë:

- Fotokopje e Kartës së Identitetit
- Fotografi personale
- Diploma e shkollës së mesme+ listën e notave
- Çertifikata familjare
- Deklarata e rregjistrimit
- Kontrata e studimeve

Duke qenë se Institucioni e vuan numrin e pakët të studentëve, ai ishte i interesuar për informimin e kontigjentëve qysh në shkollat e mesme nëpërmjet vizitave dhe takimeve në mjediset e këtyre shkollave. Pyetja nëse ky aktivitet ishte eficient mori përgjigjen që koha e shkurtër prej fillimit të këtij programi studimi nuk na lejon të tërheqim konkluzione bindëse.

Procedurat e pranimit të studentëve

Pranimi i tyre është bërë në kushtet e plotësimit të nivelit të 4 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe dokumentat bazë të funksionimit të institucionit: Statutin, Rregulloren e IAL dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Realizimi konkret i pranimit është kryer nëpërmjet aplikimit online në faqen zyrtare të Maturës Shtetërore. Ky proces

është kontrolluar nga Agjensia Kombëtare e Provimeve dhe MASR në përputhje me dispozitat ligjore, konkretisht udhëzimin nr. 13 datë 22.07.2016 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimi të ciklit të parë të studimeve, në programet e studimit me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë në institucionet e arsimit të lartë, në vitin 2016-2017” si dhe udhëzimit nr. 18, datë 16.08.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 15, datë 19.05.2017 “ Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimi të ciklit të parë të studimeve, në programet e studimit me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë në institucionet e arsimit të lartë në vitin akademik 2017-2018”. Dokumentat e kërkuar për regjistrim janë:

- Fotokopje e Kartës së Identitetit
- Diploma origjinale e Maturës Shtetërore ose origjinali i dëfteses së pjekurisë, së bashku me listën e notave ose një dëftesë/ diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njësuar nga MASR.
- Çertifikata familjare
- Fotografi

Pas dorëzimit dhe verifikimit të dokumentacionit dhe përmbushjes së kriterëve të pranimit të përcaktuara paraprakisht nga KPT, kandidati nënshkruan kontratën e regjistrimit të studentit si dhe kryen pagesën e tarifës së studimit.

Tregues të matshëm:

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve** (Tabela 14 dhe 14.1 , mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 14

Numri i studentëve		
Viti akademik 2016 – 2017	Viti akademik 2017 – 2018	Nota mesatare në hyrje
12	6	5~6
2	2	6~7
1	2	7~8
0	1	8~9
0	0	9~10

Tabela 14.1

Programi i studimit 2 vjeçar profesional në PS “Gjeodezi”	Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë)	Nota Mesatare	Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse)	Nota Mesatare
2016- 2017	15		N/A	N/A
2017-2018	11		N/A	N/A
Në total	26			

Nga të dhënat e RVB dhe sekretarisë aktualisht ndjekin studimet 25 studentë, sepse 1 student i brezit 2016-2017 është c’regjistruar.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Mobiliteti i studentëve në KPT kryhet sipas përcaktimeve në rregulloren e IAL-së. Për ta mundur realisht mobilitetin KPT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me 3 IAL brenda vendit: UPT, Universiteti "A.Moisiu" Durrës dhe Universiteti European i Tiranës. Po kështu ai ka nënshkruar memorandiumin e bashkëpunimit me Universitetin e Thesalisë, Greqi me objekt: shkëmbimin dhe zhvillimin profesional të stafit akademik dhe/ose administrativ, shkëmbim studentësh, bashkëpunim në projekte kërkimore, botime etj.

Vlerësimi sipas standardeve:

Standardi 3: Qasja e studentëve në mësimdhënie është mbështetur përmes hartimit të programit

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Hartimi i Programit të studimit është mjaftueshëm fleksibël për të mundur që studimi të përshtatet me punësimin.

Kriteri 2 Përvojat e studentëve të fituara nga puna e tyre e mëparshme, janë integruar në modulet dhe vlerësimin e studentëve.

Kriteri 3 Përbajtja e Programit është aktuale dhe i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe/ose kërkesat për aftësitë/shprehjet nga punëdhënësit.

Kriteri 4 Vlerësimi dhe feedback-u i studentëve është përdorur në mënyrë efektive, për të mbështetur studentët jo tradicionale dhe të mësuarit e nxënësve me performancë të ulët

Kriteri 5 Mësimdhënia përfshin metoda të ndryshme pedagogjike që i përshtaten studentëve të ndryshëm, p.sh. të mësuarit në veprim, puna në ekip dhe të mësuarit në formë të pavarur.

Vlerësimi sipas standardit 3:

Kurrikula e kompozuar për PS "Gjeodezi" përmban mjaftueshëm lëndë karakterizuese (B), të ngjashme apo integruese (C) si dhe me zgjedhje (D) të cilat garantojnë dhënie njohurish profesionale në kuadrin e misionit dhe objektivave të këtij programi, për t'iu përgjigjur titullimit si "Teknik i Lartë". Mbështetur në këtë kurrikul edhe syllabuset e lëndëve ofrojnë njohuri teorike (leksione) dhe njohuri praktike (ushtrime, laboratore dhe praktika në terren e profesionale), të cilat i aftësojnë të diplomuarit për të hyrë në tregun e punës. Syllabuset e lëndëve janë të tilla që mund të ndryshojnë duke u përshtatur me zhvillimet teknologjike si dhe me kërkesat specifike të tregut të punës.

Në nivelin aktual *kërkohet pasurimi i mëtejshëm i bazës laboratorike vetiake si dhe rritja e numrit të subjekteve private bashkëpunuese*, për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut për specialistë operatorë si dhe për të rritur interesimin e tij ndaj të diplomuarve të këtij PS. Në mënyrë që kurrikula e PS "Gjeodezi" në KPT të shembëllejë më mirë me kurrikulat e programeve universitare, për të lehtësuar mobilitetin e studentëve, është e nevojshme që të ndryshohen edhe disa emërtime lëndësh si:

- "Aplikacione të Gjeoshkencës (GPS+GIS)" në "Bazat e GPS dhe GIS"
- "Aplikimet e Gjeodezisë në Ndërtime" në "Gjeodezia inxhinierike"
- "Menaxhimi i punimeve në kantier" në "Punimet në kantier"
- "Teori gabimesh, korigjimi dhe optikë e aplikuar" në "Teoria e gabimeve"
- Lënda "Rrjete gjeodezike" të hiqet dhe të zëvendësohet me lëndën "Teori instrumentash" etj.

Për shkak të kohës së shkurtër të hapjes së këtij programi, akoma nuk është krijuar përvojë e tillë studentësh që ajo të integrohet në modulet e lëndëve apo vlerësimin e tyre. *GVJ rekomandoi që përvoja e krijuar me produktet e punëve laboratorike dhe praktikës në terren, të grumbullohet,*

analizohet e përpunohet për t'u marrë në konsideratë në të ardhmen.

Në analizë të përmbajtjes së programit, GVJ konstaton që ajo është aktuale dhe i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe/ose kërkesat për aftësitë/shprehjet nga punëdhënësit. Programi i aftëson studentët në krijimin e bazës së të dhënave, përpunimin dhe vlerësimin e saj si dhe vizualizimin grafik (hartografimin). Gjithashtu nëpërmejt përcaktimit të pozicionit me GPS studenti mëson një nga teknologjitë aktuale për krijimin e të dhënave, ndërkohë që njohja me bazat e sistemeve të gjeoinformacionit (GIS) bën që ata të kuptojnë edhe mundësitë e tematizimit të modeleve topografike. Të gjitha këto njohuri shërbejnë për plotësimin e kërkesave të veçanta të profesionit dhe janë në sintoni me kërkesat e tregut të punës.

Derimëtimi në plotësim të këtij kriteri shërben vetëm feedback-u i studentëve, marrë nëpërmjet intervistimit, përkatësisht anketimit të tyre. Ai ndikon në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënjes por mbetet i kufizuar për shkak të numrit të pakët të studentëve, kohës së shkurtër të aktivitetit dhe mungesës së kontigjenteve të punësuar. Gjithashtu ka munguar edhe përvoja e studentëve që vijnë jo nga burime tradicionale, që të kushtëzonte aktivitet të posaçëm në mbështetjen e tyre. Për studentët me performance të ulët janë përdorur konsultimet dhe mbështetja e punës së pavarur kryesisht në praktikën në terren, praktikën profesionale dhe punët laboratorike.

Gjatë mësimdhënies evidentohet diferenca në përvetësimin e njohurive nga studentët. Këtë e ndihmon edhe numri i pakët i studentëve në këtë PS. Me ata që kanë performancë të ulët punohet më gjatë në realizimin e produkteve vetiake të tyre si në punët e laboratorit, zgjidhjen e ushtrimeve, realizimin e volumit të caktuar të matjeve etj. Edhe puna në grup gjatë seancave të punëve laboratorike apo praktikës në terren ndikon në rritjen e performancës së tyre.

Standardi 4: Rezultatet e të mësuarit komunikohen që nga pranimi i studentëve deri në diplomim dhe janë shqyrtuar dhe vlerësuar

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Informacioni për mundësitë e regjistrimeve është i qartë dhe i publikuar, si dhe i mbështetur me udhëzime ndihmuese të stafit.

Kriteri 2 Ekziston një praktikë efektive e punës në ekip, midis stafit të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe stafit të IAL.

Kriteri 3 Synimet e programit dhe rezultatet e të mësuarit për elementët praktikë dhe akademikë janë të qarta, të mbështetura nga publikimi i rezultateve të të mësuarit në nivel moduli

Kriteri 4 Monitorimi i bibliotekës dhe i burimeve të tjera të mësimdhënies dhe të të nxënit është bërë rregullisht. Janë ndërmarrë rregullisht praktika specifike të punësimit dhe zhvillimi i aftësive.

Vlerësimi sipas standardit

Referuar numrit të studentëve që ndjekin studimet në PS “Gjeodezi”, konkludohet që ai është i pakët (25 për të dy vitet) dhe KPT synon përmirësimin e këtij treguesi. Për ta realizuar këtë ai është i interesuar të rrisë edhe përhapjen edhe cilësinë e informimit të publikut lidhur me mundësitë e regjistrimit dhe njohjen e ofertës së tij. GVJ konstaton që në këtë drejtim punohet si në aspektin e publikimeve e prezatimeve në distancë, ashtu edhe në atë të kontakteve të drejtpërdrejta me kandidatët e mundshëm. Grupi u njoh me “Politikën dhe procedurat e Komunikimit në KPT”, verifikoi dokumentacionin ekzistues lidhur me realizimin e kësaj politike dhe konkludoi që institucioni ka realizuar takime informuese me nxënësit e shkollave të mesme, ka shpërndarë materiale informuese e sqaruese lidhur me dobinë e “produkteve” të tij, ka realizuar dalje publike në media, ka marrë pjesë në panairët e karrierës dhe ka përdorur faqen zyrtare në internet për të informuar të gjithë të interesuarit lidhur me mundësitë e regjistrimit në PS “Gjeodezi”

Në RVB, plotësimi i kriterit 2 lidhet me marrëveshjet e bashkëpunimit që ka nënshkruar KPT me

institucione të tjera të arsimit të lartë, konkretisht me UPT, Universitetin “A.Moisiu”, Durrës si dhe UET. *GVJ gjykon që këtyre marrveshjeve duhet tu shtohet edhe bashkëpunimi me stafin e Arsimit dhe Formimit Profesional, në mënyrë që nëpërmjet kontakteve të organizohen e zhvillohen diskutime kolegjiale mbi kurrikulën dhe problemet që lindin në ecurinë e zbatimit të programit të studimit.*

Realizimi i programit përmbush objektivat e paisjes së studentëve me njohuri praktike e akademike. Shkalla e përvetësimit të tyre demonstron në vlerësimet e produkteve vetiake të studentëve që janë zgjidhja e ushtrimeve, realizimi i punëve laboratorike si dhe relacionet e praktikave në terren apo atyre profesionale. Njohuritë që konkretizohen në këto produkte fitohen prej studentëve nëpërmjet përvetësimit të elementëve teorikë të mësimdhënies, të cilat jepen të strukturuar në formë modulesh.

Gjatë vizitës në Bibliotekën e institucionit, GVJ u njoh me fondin e librave që ndodheshin në të, frekuentimin e saj nga studentët si dhe angazhimin e institucionit në funksion të plotësimit të kërkesave të studentëve për literaturën bazë, literaturën ndihmëse apo materiale të tjera didaktike. GVJ konstatoi që studentët i drejtoheshin bibliotekës për të marrë aty leksionet e shkruara, përmbledhje ushtrimesh të zgjidhura dhe udhëzues të punëve të laboratorit. Të gjitha në versionin hard copy. Këto materiale në versionin elektronik ofroheshin edhe në portalin on-line të institucionit.

Konkluzionet e GVJ:

Lidhur me plotësimin e standardeve 3 dhe 4, GVJ konkludon:

- PS “Gjeodezi” mbështetet në zbatimin e një kurrikule, e cila i pajis studentet me njohuri të tilla që ata ta gjejnë lehtësisht rrugën në tregun e punës. Ato aftësohen në operimin me instrumentat dhe teknologjitë e matjes; me metodologjitë e krijimit të bazës së të dhënave; me përpunimin, analizën dhe vlerësimin e të dhënave, me teknikat e vizualizimit të tyre dhe me mënyrat e kalimit të të dhënave të projekteve në terren. Konkretizimi i këtyre aftësive demonstron në zgjidhjen e ushtrimeve, në përdorimin e instrumentave e paisjeve për punët e laboratorit dhe zgjidhjen e detyrave komplekse gjatë kryerjes së praktikave në terren. *Kurrikula ka nevojë për përmirësime, sidomos për të njëzuar e standardizuar emërtimet e disa lëndëve.* Kjo nevojë diktohet për të lehtësuar mobilitetin e studentëve, për të prodhuar një suplimet diplome të lexueshëm e të kuptueshëm nga tregu i punës brenda e jashtë vendit si dhe për të qartësuar e lehtësuar procesin e licensimit. Në këtë drejtim do kontribuonte me efikasë krijimi i një grupi me specialistë nga universitetet si dhe bashkëpunimi me i ngushtë me Agjensinë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional.
- Në ecurinë e zbatimit të kurrikulës janë marrë në konsideratë propozimet e bëra nga stafi akademik për ndryshime të saj. Është e nevojshme që në zhvillimin e mëtejshëm, sidomos me punësimin e kontigjentëve të të diplomuarve nga ky PS, të merren në konsideratë edhe propozimet e studentëve e të diplomuarve. *Për këtë rekomandojmë evidentimin e të gjitha propozimeve, qysh në fazën e anketimeve e deri në atë të vlerësuesit nga pozita e të punësuarve.* Po kështu është mirë që produktet e arrira të studentëve në aktivitetin e tyre praktik, të përfshihen në syllabuset e lëndëve si baza të dhënash, në udhëzuesit e punëve të laboratorit dhe ato të praktikave.
- Programi i aftëson studentët në përdorimin e teknologjisë bashkëkohore për krijimin, përpunimin, analizën, vlerësimin dhe vizualizimin grafik të të dhënave. Po ashtu në

përfundim të programit studentët janë në gjendje të hedhin në terren projekte që lidhen me objektet inxhinierike apo industrialë.

- Anketimet e studentëve si dhe mendimet e shprehura prej tyre gjatë zhvillimit të procesit mësimor duhen konsideruar si feedback i dobishëm në përmirësimin e programit. Studentët janë imazhbërësit kryesor për një IAL, prandaj vërtetjet dhe vlerësimet e tyre duhet të kihen parasysh në të gjitha proceset e vendimmarrjes. Edhe pse në këtë PS mungojnë studentët që vijnë nga burime jo tradicionalë, Departamenti duhet të jetë i përgaditur të organizojë trajtimin e tyre gjatë gjithë procesit mësimor. GVJ e gjen me vend përvojën e krijuar për mbështetjen e studentëve me performancë të ulët qoftë nëpërmjet konsultimeve, qoftë nëpërmjet kohëzgjatjes në përgaditjen dhe realizmin e punëve laboratorike apo praktikave në terren.
- KPT e realizon mirë informimin e të interesuarve për programet e studimit që ai ofron. *GVJ gjykon që në këtë aspekt duhet rritur bashkëpunimi me subjektet private, pasi ata janë më eficientë në krijimin e bindjeve për dobinë e profesionit.*
- Për të rritur cilësinë e kurrikulës dhe për ta bërë më produktive mësimdhënien, GVJ mendon që stafi i PS “Gjeodezi” duhet të forcojë bashkëpunimin me stafet e programeve si vëllezër, veçanërisht në universitete si dhe me Agjensinë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional. Do të ishte me vlerë që për materialet didaktike të prodhuara nga stafi i PS “Gjeodezi” të kërkoheshin vlerësime edhe nga jashtë institucionit.
- GVJ vlerëson që transmetimi i njohurive praktike është në nivelin e kërkesave që lidhen me natyrën e këtij programi.
- Materialet didaktike të prodhuara nga stafi akademik i programit gjendeshin në bibliotekën e institucionit. GVJ mendon se në këtë bibliotekë do ishte mirë të depozitoheshin edhe botimet shqip të teksteve që lidhen me disiplina të ndryshme të profesionit.

Në vlerësimin tërësor GVJ konkludon që institucioni i **plotëson standardet 3 dhe 4 për PS Gjeodezi.**

10. Aktivitetet profesionale në funksion të programit të studimit

Pjesa përshkimore

Terma reference: aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e njohurive me praktikën profesionale, vlerësime zyrtare të aktivitetit individual të studentëve ose në njësinë.

Sipas RVB, aktivitetet profesionale në funksion të programit të studimit janë:

- aktivitetet e organizuara nga “Klubi i Inovacionit”, që shërben për forcimin e bashkëpunimit midis studentëve të programeve të ndryshme të studimit. Në të tre takimet e tij ishin referuar tema që lidhen me raportet midis studentëve dhe inovacioneve, të trajtuara me referencë tek inovacionet brenda institucionit.
- pjesëmarrja në aktivitetet që organizojnë të tretët,
- pjesëmarrja në panairët e karrierës, ku studentët demonstronjë kryesisht aftësitë e tyre praktike në punën me instrumentat dhe teknologjinë e institucionit,
- nxitjen e pedagogëve për të sjellë dhe ekspozuar punimet e tyre të realizuara gjatë karrierës profesionale, si një përvojë frymëzuese dhe motiv krenarie për studentët dhe aktivitetet trajnuese për stafin.

- Trajnimet e stafit në kuadrin e bashkëpunimit me Polytech.

GVJ, gjatë vizitës në institucion, konstatoi egzistencën e dokumentacionit lidhur me këto aktivitete. Sa i përket aktiviteteve në kuadrin e PS “Gjeodezi” u konstatua që deri më tani studentët e këtij programi ishin thjesht pjesëmarrës pasi edhe koha qysh nga fillimi i zbatimit të këtij PS është e shkurtër.

Konkluzionet e GVJ:

GVJ gjykon që aktivitetet e deritanishme duhet të jenë fillesa për aktivitete të tjera. Ato duhet ta mbajnë gjallë dhe ta zhvillojnë më tej pasionin për profesionin e zgjedhur. Referimet e studentëve të PS “Gjeodezi” lidhur me produktet e krijuara prej tyre do të shtojnë interesin për këto produkte, do nxisin frymën kritike në vlerësimin e tyre dhe do t’i inkurajojë ata për të hyrë më të sigurtë në tregun e punës. *GVJ mendon që aktivitetet profesionale duhet të organizohen edhe në ambientet e subjekteve private, nëpërmjet referimit të projekteve të hartuara dhe të zbatuara nga këto subjekte.*

Mbështetur në përvojën e krijuar dhe angazhimin institucional për të përmirësuar imazhin e KPT-së në mënyrë që të përthithin sa më shumë kontigjente, GVJ vlerëson që institucioni i **përbush këto standarde.**

11. Bashkëpunimi kombëtar (dhe ndërkombëtar)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Bashkëpunimet e realizuara nga njësia kryesore me tregun e punës që lidhet me këtë program studimi, si në nivel rajonal ashtu edhe në nivel kombëtar/ ndërkombëtar. Përfitimet institucionale, në nivel program apo në nivel studentësh gjatë këtyre bashkëpunimeve.

Bashkëpunimi i KPT si në planin kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar realizohet nëpërmjet nënshkrimit e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit. Në planin kombëtar këto marrëveshje janë nënshkruar me institucione dhe me subjekte private. Nga shqyrtimi i këtyre marrëveshjeve, GVJ konstatoi që, posaçërisht për programin e studimeve “Gjeodezi”, është nënshkruar marrëveshje vetëm me subjektin privat Gjeo-Vjosa Shpk. Nëpërmjet saj është realizuar jo vetëm pranimi i studentëve në këtë subjekt për të kryer praktika apo angazhimi i personelit të këtij subjekti si PAK, por edhe vënja në dispozicion nga firma e bazës së saj instrumentale (Total Station, Sistem GPS, nivelë dixhitale).

Marrëveshjet e nënshkruara nga KPT me institucione të Arsimit të Lartë (UPT, Universiteti “A.Moisiu”, Durrës, UET) janë në funksion të kontraktimit të personelit akademik të këtyre institucioneve për të mbuluar si PAK procesin mësimor në programet e studimit të KPT. Në takimet me rektorin dhe shefat e Departamenteve, GVJ mësoi që synimi i tyre është të angazhojnë sa më shumë personel të këtyre institucioneve, pasi ata janë të kualifikuar dhe më përvojë dhe, kanë ndikim si në rritjen e cilësisë të mësimdhënies ashtu edhe në përmirësimin e kurrikulës dhe syllabuseve.

Në të ardhmen KPT ka në plan ta shtrijë bashkëpunimin edhe me subjekte apo institucione të huaja të cilat ofrojnë programe mësimore të ngjashme. Synohet që ky bashkëpunim të ndikojë në rritjen e mobilitetit për studentët e kolegjit dhe në shtimin e shkëmbimit të përvojave midis personelit akademik. Për personelin akademik në proces kualifikimi, do synohet dhe realizimi i kualifikimit të tyre nëpërmjet këtyre marrëveshjeve bashkëpunimi.

Tregues të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar (dhe ndërkombëtar)** (Tabela 16, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 16

Aktivite individuale ose në rang Institucioni, në kuadër të bashkëpunimit kombëtar në vitet e fundit		
1	Trajnim i stafit akademik dhe administrativ për sistemin classter nga Verti Tech S.A	
2	Trajnim për studentët nga UNEP në bashkëpunim me Minitrinë e Mjedisit	
3	Trajnim stafi nga nga kompania Polytech.	

Konkluzionet e GVJ:

KPT e ka orientuar bashkëpunimin e tij në këto drejtime:

- Bashkëpunim me Institucione të Arsimit të Lartë
- Bashkëpunim me subjekte private, aktiviteti i të cilave përkon me programet e studimeve të kolegjit
- Bashkëpunim me kompani të huaja të cilat ofrojnë teknologji të kërkuar për krijimin dhe zgjerimin e bazës laboratorike.
- Bashkëpunim me subjekte jashtë vendit që ofrojnë programe të ngjashëm.

Në të gjitha këto drejtime KPT ka arritur të përfitojë rekrutimin e personelit të kualifikuar, hapësirë konkrete për realizimin e ngarkesës praktike të procesit mësimor, teknologjinë e nevojshme për kryerjen e punëve të laboratorit dhe praktikave etj.

Sa i përket PS “Gjeodezi” konstatohet që egziston vetëm një marrëveshje me një subjekt privat, me aktivitet në fushën e matjeve gjeodeziko-topografike. GVJ rekomandom rritjen sa më të shpejtë të numrit të këtyre marrëveshje, për të përfituar mundësi më të shumta lidhur me zhvillimin e praktikave, realizimit të punës së pavarur të studentëve, shtimit të kontigjentëve për rregjistrimet si dhe punësimeve.

Mbështetur në arritjet konkrete në fushën e bashkëpunimit, kryesisht kombëtar por edhe ndërkombëtar, GVJ konkludon që institucioni i **përmbush standardet përkatëse.**

ANALIZA SWOT

Analiza përmbledhëse sipas metodës SWOT (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats).

a. Pika të forta

1. Programi i studimit “Gjeodezi” në KPT është hapur duke marrë në konsideratë nevojat e tregut të punës për specialistë të këtij profesioni. I lidhur kryesisht me aktivitetin e ndërtimit dhe urbanistikës ai mbetet gjithmonë i kërkuar si nga sektori privat ashtu edhe nga ai publik.
2. Institucioni ofron kushte të mira për akomodimin e këtij PS si në ambiente ashtu edhe në mjete mësimore.
3. Programi zhvillohet mbështetur në një kurrikulë optimale dhe ka një kohëzgjatje që i motivon kandidatët të rregjistrohen në të.
4. Personeli akademik i angazhuar në PS “Gjeodezi” ka përvojë mësimdhënie por ka edhe përvojë pune në terren, çfarë është në përputhje me objektivat e këtij PS, për të realizuar një formim funksionues në aspektin teorik dhe solid në aspektin praktik.

5. Numri i pakët i studentëve përbën avantazh në realizimin e komunikimit student-pedagog pasi rrit kontrollin mbi njohuritë e fituara nga studenti jo vetëm në auditor por edhe gjatë punës së pavarur të tij.
6. Disponimi i teknologjisë dixhitale dhe sistemeve GPS i aftëson studentët për të zotëruar teknologjinë aktuale të tregut të punës.
7. Kërkesa për realizimin e produkteve vetiake nga ana e studentëve gjatë praktikës në terren dhe asaj profesionale i vendos ata në kushtet e kërkesave si specialistë duke ua rritur sigurinë për të hyrë në tregun e punës.

b. Pika të dobëta (ose pikat ku ka vend për përmirësim)

1. Mungesa e efikasitetit të programit për shkak të numrit të vogël të studentëve. Garantimi i financimeve nga burime të tjera është zgjidhje afatshkurtër.
2. Angazhimi i një pedagogu në disa lëndë të kurrikulës. Aktualisht 2 pedagogë japin 7 lëndë (4+3) çfarë ul rendimentin e mësimdhënies.
3. Mungesa e kontigjentit të të punësuarve.
4. Mungesat në realizimin konkret të mobilitetit të studentëve.
5. Mungesa e një oponente jashtë institucionale lidhur me nivelin e syllabuseve.
6. Cilësia e ulët e kontigjenteve hyrëse
7. Bashkëpunimi i kufizuar me subjekte private (vetëm 1 subjekt)

c. Mundësitë

1. Përmirësimi i mëtejshëm i imazhit të KPT duke rritur frekuencën dhe efikasitetin e takimeve me burimet e kontigjenteve dhe kontaktet me opinionin publik.
2. Rritja e numrit të marrëveshjeve me subjektet private që operojnë në fushën e gjeodezisë.
3. Rritja e bazës laboratorike si pronë e institucionit.
4. Rritja e numrit të PAE si për të përmirësuar raportin me PAK ashtu edhe për të zvogëluar numrin e lëndëve për pedagog.
5. Formulimi i emërtimeve të lëndëve në mënyrë të tillë që të unifikohen me emërtimet në programet e njëjta/ngjashme të ILA-ve të tjera.
6. Konsultimi i vazhdueshëm i syllabuseve për të realizuar në kohë e më cilësi përshtatjen e tyre si me zhvillimet teknologjike ashtu edhe me tregun e punës.
7. Rritja e mëtejshme e përgjegjësisë së stafit dhe vetëdijes së studentëve për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë

8. Kryerja e një studimi lidhur me nivelin e tarifave të studentëve dhe detyrimet kontraktuale të personelit për të rritur më tej interesin për rregjistrime dhe për punësim në KPT.
9. Kritjen e numrit të aktiviteteve profesionale sidomos për të promovuar produktet vetiake të studentëve të PS “Gjeodezi”, të krijuara gjatë aktivitetit të tyre praktik apo enkas në kushtet e bashkëpunimit me pedagogët dhe personelin e subjekteve private

d. Pengesat

1. Mungesa e efektivitetit për shkak të numrit të vogël të studentëve
2. Konkurenca me studimet universitare
3. Mungesa e përvojës në tregun e punës për të prezantuar modelin e funksionimit dhe suksesit të këtij PS
4. Mentaliteti i studentëve për ta gjykuar këtë nivel diplomimi si jo të plotë në konkurrencën për vendet e punës.

SWOT ANALYSE

Summary Analysis by SWOT (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats)

a. Strong points

1. The study program “Geodesy” of KPT was established considering the needs of the labor market for specialists in this profession. Bound to construction and urbanism this profession is requested from the businesses sector and state sector.
2. The institution offers a good framework for the PS both in ambient settings as well as learning facilities.
3. The study program has an optimal curriculum; moreover its runtime motivates the candidates to apply for it.
4. The academic staff engaged in PS “Geodesy” count for a long-standing academic experience as well as for practical experiences in field which is in compliance to the objectives of this PS, a good forming of the theoretical aspects and a solid practical experience.
5. The modest number of registered students results to have a positive effect on the communication between professor and student.
6. Provided with digital technology and GPS systems students can be trained for handling the latest technology at their later work.
7. Students are motivated to make their own products during practical courses and professional courses so they have the necessary experience as specialists later at the labor market.

b. Weak point (or points where there are opportunities for improvement)

1. Lack of efficiency of the study program because of the low number of applicants. Financial support from other sources is a short-term solution.

2. Recruitment of one professor in many subjects. Currently two professors teach seven subjects (4+3) which reduces the teaching performance.
3. Missing labor contingence.
4. Lack of student mobility facilities.
5. Lacking institutional concurrence to compare the syllabus level.
6. Low quality of entering contingents.
7. Limited cooperation to private businesses (only 1)

c. Improvement opportunities

1. Improvement of the public relations of the KPT by increasing the efficiency and frequency of appointments with sources of contingents as well as the contact to public opinion.
2. Increasing the number of agreements with businesses, which operate in the geodesy field.
3. The institution should own labor stakes.
4. Increasing the number of PAE to improve the relation with PAK also to low the number of teaching subjects per professor.
5. Transforming the designation of subjects in such a way that they are unified with the names in the same / similar programs of other ILAs.
6. Continuous syllabus consultation to realize timely and quality adaptation to both technological developments and the labor market.
7. Increase the consciousness of the working staff as well as of the attending students in order to establish and improve education quality.
8. Conduct a study on the level of student fees and contractual staffing obligations to further increase the interest for enrollment and employment in the KPT.
9. Increase the number of professional activities, especially for the promotion of the products from the pupils studying PS "Geodesy", created during their practical activity in cooperation with pedagogues and private subjects

d. threats

1. Lack of effiience as a cause of low applicants.
2. Competitiveness with Universitary studies.
3. Lack of empirical facts in the labour market which could help with presenting a model of success for the PS.
4. Students might see this diploma as not sufficient for their later working careers.

Grupi i Vlerësimit të jashtëm:

Prof. As. Gafur MUKA
Dr. Thomaq KOBLARA

